



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE**

**"Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin"**

**Tiranë, 2025**

# P Ë R M B A J T J A

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. PËRMBLEDHJE</b> .....   | <b>4</b>  |
| <b>2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT</b> .....  | <b>5</b>  |
| 2.1 Konteksti i problemit social.....   | <b>5</b>  |
| 2.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....   | <b>5</b>  |
| <b>3. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM</b> .....   | <b>6</b>  |
| 3.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....   | <b>6</b>  |
| 3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....   | <b>8</b>  |
| 3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....   | <b>9</b>  |
| 3.4 Pesha në buxhet.....  | <b>11</b> |
| 3.5 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....  | <b>12</b> |
| <b>4. DETAJET E AUDITIMIT</b> .....   | <b>12</b> |
| 4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....   | <b>12</b> |
| 4.2 Objektivi i auditimit.....  | <b>14</b> |
| 4.3 Pyetjet e auditimit.....  | <b>15</b> |
| 4.4 Fushëveprimi i auditimit.....   | <b>16</b> |
| <b>5. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE</b> .....  | <b>16</b> |
| 5.1 A ndiqen procedurat e duhura për prodhimin dhe certifikimin e ujit të<br>ambalazhuar ?.....                                     | <b>16</b> |
| 5.2 A kryhet monitorimi dhe survejanca e nevojshme në zinxhirin e proceseve deri në<br>daljen në treg të ujit të ambalazhuar ?..... | <b>32</b> |
| 5.2.1 <i>A realizohen analizat e nevojshme laboratorike ?</i> .....   | <b>32</b> |
| 5.2.2 <i>A kryhen monitorimet dhe bashkëveprimet e duhura nga institucionet<br/>                përgjegjëse?</i> .....              | <b>42</b> |
| 5.3 A garantohet informacioni i plotë dhe transparenca për qytetarin lidhur me ujin<br>e ambalazhuar?.....                          | <b>51</b> |
| <b>6. SHTOJCAT</b> .....  | <b>55</b> |

## Lista e shkurtimeve

| <b>Shkurtimi</b> | <b>Emërtimi i Plotë</b>   |
|------------------|---|
| <b>RSH</b>       | Republika e Shqipërisë  |
| <b>BE</b>        | Bashkimi Evropian   |
| <b>KLSH</b>      | Kontrolli i Lartë i Shtetit                                       |
| <b>VKM</b>       | Vendim i Këshillit të Ministrave                                  |
| <b>OBSH</b>      | Organizata Botërore e Shëndetësisë                                |
| <b>MSHMS</b>     | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale                    |
| <b>MZHBR</b>     | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural                        |
| <b>AKU</b>       | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit                                    |
| <b>DRAKU</b>     | Drejtori Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit              |
| <b>AMBU</b>      | Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore                           |
| <b>ZABU</b>      | Zyrat e Administrimit të Burimeve Ujore                           |
| <b>OSHKSH</b>    | Operatori Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor                      |
| <b>DROSHKSH</b>  | Drejtori Rajonale të Operatorit Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor |
| <b>NJVKSH</b>    | Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor                             |
| <b>ISHP</b>      | Instituti i Shëndetit Publik                                      |
| <b>ISHSH</b>     | Inspektorati Shtetëror Shëndetësor                                |
| <b>ERRU</b>      | Enti Rregullator i Ujit   |
| <b>DPD</b>       | Drejtorja e Përgjithshme e Doganave                               |
| <b>DPT</b>       | Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve                               |
| <b>INSTAT</b>    | Instituti i Statistikave  |
| <b>EUROSTAT</b>  | The statistical office of the European Union                      |
| <b>SKZHI</b>     | Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim                    |
| <b>PKIE</b>      | Plani Kombëtar për Integrimin Evropian                            |
| <b>OZHQ</b>      | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm                            |
| <b>INTOSAI</b>   | The International Organization of Supreme Audit Institutions      |
| <b>EUROSAI</b>   | The European Organisation of Supreme Audit Institutions           |
| <b>ISSAI</b>     | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit   |
| <b>3E</b>        | Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti                            |
| <b>SWOT</b>      | Fuqitë, Dobësitë, Shanset, Kërcënimet                             |

## 1. PËRMBLEDHJE

Auditimi me temë "Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin", kishte si objektiv kryesor vlerësimin e veprimtarive të institucioneve përgjegjëse lidhur me garantimin e cilësisë së ujit që hidhet në treg për qytetarin. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëpërmjet identifikimit të mangësive, shkallën e zbatimit të standardeve dhe propozimin e masave korrigjuese për të përmirësuar proceset.

Periudha e auditimit ishte nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2024. Auditimi u fokusua në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me disa njësi varësie, Institutin e Shëndetit Publik, Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me disa njësi varësie, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit së bashku me disa drejtori rajonale, si dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Subjektet e përzgjedhur si edhe periudha e auditimit ishte për të pasur një panoramë më të plotë lidhur me kompetencat dhe proceset që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të mirë menaxhimit dhe sigurisë për qytetarin. Auditimi u orientua në disa kolona bazë sa i përket veprimtarive dhe procedurave të ndjekura për dhënien e lejeve dhe licencave të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, kontrollet/monitorimet që realizohen përgjatë proceseve, kryerjen e analizave laboratorike, bashkëveprimin mes institucioneve si dhe informimin dhe transparencën për qytetarin.

Sistemi i ngritur nuk arrin të sigurojë cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar që hidhet në treg. Megjithatë konsumi i këtij produkti ka pësuar rritje të vazhdueshme, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të përmbushin plotësisht detyrimet e tyre sa i përket kontrollit, monitorimit e analizimit të tij. Ndryshimet e kompetencave në strukturat shtetërore, kanë krijuar paqartësi në rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe kanë ndikuar në funksionimin e copëzuar të sistemit. Kuadri ligjor e rregullator paraqitet i paqartë dhe kontradiktor, nuk garanton konkurrueshmërinë mes projekteve për përdorimin e burimit ujor dhe ka kriteret jo të plota për dhënien e lejeve dhe licencave. Nga ana tjetër, analizimet e mangëta laboratorike, bashkëveprimet e munguara mes institucioneve si dhe transparenca e cunguar nuk kanë garantuar cilësinë e ujit të ambalazhuar dhe sigurinë e nevojshme për qytetarin.

Sa më sipër, masat e marra nga institucionet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë për të garantuar qytetarin lidhur me ujin e pijshëm të ambalazhuar nuk janë të mjaftueshme. Evidentohen paqartësi të theksuara lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e tyre, sa i përket këtij produkti. Kjo lidhur me analizimin dhe monitorimin e proceseve përgjatë fazave nga burimi ujor deri në daljen e tij në treg. Kapacitetet laboratorike në dispozicion të autoritetit përgjegjës për ushqimin kanë mbuluar një numër të ulët elementësh për tu analizuar, ndërkohë nga institucionet shëndetësore rajonale janë bazuar kryesisht në mostra të sjella vullnetarisht nga subjektet tregtare. Analizat për importimin e produktit në pikat kufitare paraqesin problematika për shkak të tarifave. Inspektimet nga strukturat rajonale për ushqimin dhe marrja e mostrave kryhen kryesisht në stabilimentet e ujit të cilat ndodhen brenda juridiksionit territorial të tyre, dhe në pak raste në treg për marka të ndryshme që shiten. Veprimtaritë lidhur me dhënien e lejeve të burimeve ujore dhe kriterëve të përdorura për miratimin e licencave të stabilimenteve paraqesin nevojën për rishikim. Bashkëpunimi dhe koordinimi mes institucioneve paraqitet i pakët dhe i kufizuar. Në raste të caktuara institucionet kanë tentuar të lidhin marrëveshje bashkëpunimi mes tyre por pa rezultat. Veprimet e përbashkëta në drejtim të kryqëzimit të informacionit dhe përmirësimit të gjendjes mungojnë. Ndërkohë informimi dhe transparenca për qytetarin paraqitet e pjesshme dhe jo plotësisht e përshtatshme.

Në përfundim janë gjeneruar gjetje të cilat theksojnë mangësi të subjekteve nën auditim për të cilat janë dhënë rekomandime specifike shoqëruar me afatet kohore konkrete për zbatimin e tyre.

## 2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

### 2.1 Konteksti i Problemit Social

Uji është jetë !

Pa ujë, njerëzit mund të mbijetojnë vetëm disa ditë. Uji përbën 75% të peshës trupore tek foshnjat deri në 55% tek të moshuarit<sup>1</sup> dhe është thelbësor për hemostazën dhe jetën qelizore. Sasia e ujit që një person duhet të pijë ndryshon në varësi të nivelit të aktivitetit, kushteve shëndetësore, gjatësisë dhe peshës, gjinisë dhe faktorëve të tjerë.

Rekomandohet që meshkujt të pinë 13 gota (rreth 3 litra) ujë çdo ditë. Grave u rekomandohet të pinë 9 gota (pak më shumë se 2 litra) ujë çdo ditë. Gratë shtatzëna duhet të pinë 10 gota ujë në ditë, ndërsa gratë ato me fëmijë të porsalindur duhet të pinë 12 gota. Fëmijët dhe adoleshentët duhet të pinë 6 deri në 8 gota ujë në ditë. Përsëri, gjithçka varet nga niveli i aktivitetit, mosha, pesha, etj.<sup>2</sup>

Sigurimi i ujit të pijshëm të sigurt është kritik pasi shumë sëmundje të shkaktuara nga uji mund të prekin banorët, veçanërisht të rinjtë (21% e sëmundjes në Indi janë të shkaktuara nga uji). Simptomat e zakonshme mund të fillojnë me ethe, dhimbje stomaku, diarre, të cilat nëse nuk trajtohen në kohë mund të çojnë në komplikime serioze.<sup>3</sup>

Raporte të Organizatës Botërore të Shëndetësisë paraqesin fakte si më poshtë:

Në vitin 2021, mbi 2 miliardë njerëz kanë jetuar në vende me stres të ujit, gjë që pritet të përkeqësohet në disa rajone si rezultat i ndryshimeve klimatike dhe rritjes së popullsisë.

Në vitin 2022, globalisht, të paktën 1.7 miliardë njerëz kanë përdorur një burim uji të pijshëm të kontaminuar me fekale. Ndotja mikrobiale e ujit të pijshëm si rezultat i kontaminimit me fekale përbën rrezikun më të madh për sigurinë e ujit të pijshëm.

Uji i sigurt dhe i mjaftueshëm lehtëson praktikën e higjienës, e cila është një masë kyçe për të parandaluar jo vetëm sëmundjet diarreike, por edhe infeksionet akute të frymëmarrjes dhe sëmundjet e shumta tropikale të neglizhuara.

Uji i pijshëm i kontaminuar mikrobiologjikisht mund të transmetojë sëmundje të tilla si diarrea, kolera, dizenteria, tifoja dhe poliomieliti dhe vlerësohet të shkaktojë afërsisht 505 000 vdekje nga diarreja çdo vit.

Në vitin 2022, 73% e popullsisë globale (6 miliardë njerëz) përdorën një shërbim të menaxhuar në mënyrë të sigurt të ujit të pijshëm – domethënë, një ujë i vendosur në ambiente, i disponueshëm kur është e nevojshme dhe pa kontaminim.<sup>4</sup>

Në raport me situatën globale Shqipëria është një vend i pasur me burime ujore. Aktualisht, Shqipëria siguron plotësimin e rreth 90% të nevojave të furnizimit nëpërmjet ujërave nëntokësore, të cilat kanë origjinën nga burimet natyrore dhe akuiferët nëntokësore.

Shqipëria karakterizohet nga burime të shumta ujore nëntokësore, të cilat dalin në formë natyrore në sipërfaqe. Këto burime kanë karakteristika shumë të mira fiziko-kimike dhe plotësojnë kushtet për t'u klasifikuar në burime potenciale për të siguruar nevojën për ujë të pijshëm.<sup>5</sup>

Megjithëse burimet ujore paraqesin potencial të lartë për furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm, konsumi i ujit të ambalazhuar në Shqipëri është i lartë.

INSTAT publikon të dhënat e Anketës së Produkteve Industriale (PRODCOM) sipas Listës së Produkteve Industriale në nivel të detajuar 8- shifror, e cila përdoret në vendet e Bashkimit Evropian.

<sup>1</sup> <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC2908954/>

<sup>2</sup> <https://health.ucdavis.edu/blog/good-food/why-its-important-for-you-to-drink-water-and-stay-hydrated/2022/07>

<sup>3</sup> <https://www.doconline.com/blog/water-life-in-every-drop>

<sup>4</sup> <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/drinking-water>

<sup>5</sup> Vendim Nr. 448, datë 26.7.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030

Konsumi i produktit “Ujë mineral dhe ujë i gazuar” paraqet një ecuri në rritje. Nga rreth 316.1 milion litra në vitin 2022 shkon në rreth 382.7 milion litra në fund të vitit 2023<sup>6</sup> duke shënuar një rritje prej 21%.

Uji konsumohet direkt ose indirekt si ushqimet e tjera, duke kontribuar kështu në ekspozimin e përgjithshëm të konsumatorit ndaj substancave nëpërmjet tij, duke përfshirë kimikatet dhe ndotës mikrobiologjik. Për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor tashmë mund t'i referohemi Direktivës së Komisionit Evropian 2003/40/EC, Direktivës së Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2009/54/EC, por jo vetëm, të cilat janë udhërrëfyes për institucionet vendase mbi qasjen dhe standardet që duhet të ndjekin gjatë veprimtarisë së tyre.

Uji duhet të jetë zgjedhje për konsumatorin por jo zgjidhje!

## **2.2 Rëndësia e auditimit të performancës**

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performancë. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficientia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, u ndërmorr auditimi me temë, "Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin", duke e konsideruar një çështje të rëndësishme dhe me impakt social. Ky auditim është i pari i këtij lloji dhe çështjet që ai do të trajtojë do të kenë interes të lartë për publikun. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me certifikimin dhe cilësinë e ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin, duke synuar që të adresojë shkaqet kryesore që mund të cenojnë sigurinë e tij. Në përfundim do të jepen rekomandimet përkatëse, për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

## **3. SUBJEKTET NËN AUDITIM**

### **3.1 Hyrje në subjektet nën auditim**

Subjektet që u përfshinë në këtë auditim janë:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësi në varësi të saj;  
-Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoritë Rajonale Tiranë, Durrës, Fier, Gjirokastrë;
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe njësi në varësi të saj;  
-Instituti i Shëndetit Publik;  
-Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;  
-Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë;
3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

<sup>6</sup> <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%3ABRbimet/anketa-e-produkteve-industriale-prodcom/publikime/2024/anketa-e-produkteve-industriale-prodcom-2023/>

### **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)**

MBZHR, referuar legjisllacionit në fuqi, ka për mision konceptimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe të reformës legjisllative në këtë sektor.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese, misioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është zbatimi i programit të qeverisë në fushën e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve, bimëve, dhe garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që mund të vijnë nga kafshët dhe cilësia e ushqimeve.

### **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)**

AKU është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ajo organizohet në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel Rajonal nëpërmjet drejtorive rajonale në qarqe. Institucioni ka si detyrë të garantojë sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve e ushqimeve për kafshë në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet kryerjes së veprimtarive inspektuese, teknike dhe shkencore në këtë fushë. Institucioni e ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit dhe ka fushë përgjegjësie sigurinë e ushqimit në të gjithë zinxhirin e saj.

AKU-ja ka përgjegjësi:

- a) të ofrojë mendim shkencor për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, vlerat ushqimore të ushqimit dhe të përgatisë standardet në këtë fushë;
- b) të organizojë punën për kryerjen e veprimtarisë inspektuese në përputhje me fushat e saj të përgjegjësisë;
- c) të organizojë punën për analizimin, vlerësimin dhe komunikimin e riskut për ushqimin dhe ushqimin për kafshë;
- ç) të organizojë punën për trajnimin e certifikimin e inspektorëve të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore.

### **Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)**

MSHMS ka për mision hartimin e zbatimin e politikave dhe të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor e për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor.

### **Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)**

ISHP është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ai ka si mision veprimtarinë kërkimore-shkencore, survejancën<sup>7</sup> e sëmundjeve dhe monitorimin e gjendjes, duke analizuar shkaqet dhe zgjidhur në kohë problemet për shëndetin e popullatës. Zhvillimin dhe aplikimin e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve, dëmtimeve, paaftësive, e faktorëve dëmtues shëndetësorë të mjedisit, dhe zhvillimin dhe aplikimin e promocionit të shëndetit, në bashkëpunim të ngushtë me agjenci/organizma/organizata kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo identifikon dhe monitoron risqet kryesorë të shëndetit, ndërmerr dhe zhvillon dhe rritjen e shkallës së informimit të popullatës, edukimin dhe ndërgjegjësimin e saj mbi problemet shëndetësore, etj.

### **Operatori Shërbimit Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH)**

OSHKSH është strukturë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ai organizohet në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal nëpërmjet drejtorive rajonale, përkatësisht, nëpërmjet DROSHKSH Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër, njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë njësitë vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH), qendrat shëndetësore/klinikat dhe institucionet shëndetësore me shtretër/spitalet. Njësitë vendore kanë rol në vlerësimin e rasteve, përfshirë analizimet

---

<sup>7</sup> Term i cili i referohet Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e ISHP”.

laboratorike, kur ka informacione për intoksikacion me natyrë hidrike apo devijime të parametrave të ujit të nga normat e përcaktuar.

### **Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)**

Misioni i Agjencisë është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe prioritizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike. Agjencia organizohet në nivel qendror dhe në nivel baseni ujqor nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore, degë të saj, në përputhje me basenet ujore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim**

### **3.2.1 Kriteret ligjore dhe nënligjore:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar;
- Ligji 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i shfuqizuar nga Ligji nr. 29/2024 “Për burimet ujore”;
- Ligj nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 10138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7643 datë 2.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i shfuqizuar nga Ligji nr. 99/2024;
- Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 366 datë 16.06.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 696, date 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografik të baseneve ujore në republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre”;
- VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” të ndryshuar;
- VKM nr. 708 datë 09.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”;
- VKM nr. 221 datë 26.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”;
- VKM nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”;
- Të tjera.

### **3.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit**

- VKM nr. 379, date 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e Ujit të pijshëm”;
- VKM nr. 434, datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”;
- VKM nr. 550, datë 15.07.2020 “Për miratimin paraprak të formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, rinovimit, dokumenteve shoqërues, formateve të miratimit në parim, lejes e autorizimit, kushtet e përgjithshme e të posaçme të lejeve e autorizimeve, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, si dhe afatet e vlefshmërisë”;
- VKM nr. 993, datë 9.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkuftare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre”;

- VKM nr. 1014, datë 16.12.2020 “Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujore;
- Urdhër Ministri nr. 314, datë 27.10.2010 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e listës, kufijve të përqendrimit dhe kërkesat për etiketimin, për përbërësit natyralë të ujërave minerale dhe kushtet për përdorimin e ajrit të pasuruar me ozon për trajtimin e ujërave minerale natyrale dhe ujërave të burimit”;
- Urdhër Ministri nr. 266 datë 29.08.2011 “Për miratimin e rregullores për industrializimin dhe tregtimin e ujërave mineralë natyralë”;
- Urdhër Ministri nr. 13 , datë 22.11.2012 “Për miratimin e rregullores “për përcaktimin e kushteve të përdorimit të aluminit aktiv, për largimin e florit nga uji mineral natyral dhe uji burimit”;
- Të tjera.

#### *Kriteret të tjera/Direktiva, Udhëzues*

- Direktiva e Komisionit Evropian 2003/40/EC<sup>8</sup> e datës 16 maj 2003 që përcakton listën, kufijtë e përqendrimit dhe kërkesat e etiketimit për përbërësit e ujërave minerale natyrore dhe kushtet për përdorimin e ajrit të pasuruar me ozon për trajtimin e ujërave minerale natyrore dhe ujërave të burimeve;
- Direktiva 2009/54/EC<sup>9</sup> e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 qershor 2009 mbi shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrore;
- Udhëzuesi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë<sup>10</sup> “Cilësia e ujit të pijshëm”;
- Direktiva 2020/2184<sup>11</sup> e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor.
- Të Tjera.

### **3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit**

Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar ka për qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesat e konsumatorit duke përcaktuar përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, të prodhuara në Republikën e Shqipërisë ose të importuara dhe të nxjerra në treg në Republikën e Shqipërisë<sup>12</sup>.

Në kuptimin e këtij ligji termi “ushqim” përfshin edhe ujin:

- a) të përdorur si ujë të pijshëm për furnizimin publik të popullsisë;
  - b) të përdorur dhe/ose të bashkuar në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij;
- Për të përcaktuar nëse një ushqim nuk është i sigurt duhen pasur parasysh:
- a) kushtet normale të përdorimit të ushqimit nga konsumatori dhe çdo fazë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes;
  - b) informacioni që i jepet konsumatorit, përfshirë informacionin e dhënë në etiketë ose informacione të tjera, të vlefshme për parandalimin e efekteve të dëmshme, specifike për shëndetin nga një ushqim i caktuar ose nga një kategori ushqimesh.

Ligji i mësipërm “Për Ushqimin”, i ndryshuar përcakton edhe:

- Kërkesat e përgjithshme të etiketimit të ushqimit
- Kontrollin zyrtar të ushqimeve nëpërmjet përfshin një ose më shumë nga veprimtaritë e mëposhtme: a) inspektimin; b) marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave; etj
- Parimet e përgjithshme të kontrollit zyrtar të ushqimit

Kontrolli zyrtar i ushqimit kryhet:

- a) rregullisht dhe në përputhje me përparësitë e përcaktuara në skemën e vlerësimit të riskut;

<sup>8</sup> <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2003/40/oj/eng>

<sup>9</sup> <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2009/54/oj/eng>

<sup>10</sup> <https://www.who.int/publications/i/item/9789241549950>

<sup>11</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32020L2184>

<sup>12</sup> Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, neni 1, pika h.

b) kur ka arsye për të besuar se kërkesat e këtij ligji nuk janë plotësuar.

- Marrja e mostrave për analizat laboratorike

Për qëllim të kontrollit zyrtar të ushqimeve merren mostra të materialeve të papërpunuara të përbërësve, shtesave teknologjike dhe të substancave të tjera, të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimeve, ushqimeve gjysmë të gatshme, ushqimeve të gatshme, materialeve në kontakt me ushqimet, përfshirë substancat që përdoren për pastrimin dhe mirëmbajtjen në biznesin ushqimor.

- Veprimtaritë e laboratorëve të autorizuar të kontrollit.

Me Vendim nr. 366 datë 16.06.2023, është miratuar Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023-2027, e cila synon sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve<sup>13</sup> në të cilën nuk përfshihet në mënyrë specifike ndonjë objektiv që lidhet me ujin e pijshëm të ambalazhuar. Kontrolli zyrtar i ushqimeve nga në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, realizohet nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pra nga AKU. Kjo e fundit pas ndryshimeve ligjore të Ligjin nr. 7463, datë 02.12.1992 “Për Inspektimin Sanitar” me Ligjin nr. 54/2020 është ngarkuar të kryej edhe inspektimin sanitar për produktet ushqimore.

Nga ana tjetër institucionet shëndetësore ISHP dhe NJVKSH nëpërmjet strukturave të tyre kanë si detyrë mbrojtjen e shëndetit dhe promovimin e jetesës së shëndetshme të popullatës dhe konkretisht ISHP:

- kryen studime dhe hulumtime në lidhje me vlerësimin e risqeve mjedisore, impaktin në shëndet, nëpërmjet kryerjes së ekspertizave.
- bën vlerësimin e cilësisë së ujit të pijshëm (ujëra nëntokësorë/ujëra sipërfaqësorë me destinacion për ujë të pijshëm/vepra të trajtimit të ujit)
- ndjek dhe mban nën kontroll të vazhdueshëm, nëpërmjet analizës së të dhënave nga strukturat shëndetësore, situatën e furnizimit me ujë të pijshëm dhe cilësinë e tij në nivel kombëtar, jep rekomandime dhe detyra për zbatim duke vlerësuar faktorët e riskut.
- propozon dhe punon në vazhdimësi në lidhje me përmirësimin e legjislacionit, standardeve dhe normave duke pasur parasysh përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së.
- ofron ndihmë tekniko-profesionale për specialistët e shëndetit publik, shërbimit të higjienës dhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, ofron trajnimin dhe kualifikimin e specialistëve të shëndetit mjedisor me anë të seminareve, si dhe trajnimin dhe edukimin universitar në Shëndetin Publik.
- është qendër reference në shëndetin publik;
- informimin e popullatës rreth çështjeve të shëndetit publik.

Ndërsa NJVKSH-të si strukturat vendore shëndetit kanë rol vlerësues dhe analizues të rasteve kur cenohen parametrat të ujit kjo edhe në bashkëpunim me ISHP.

Menaxhimi i burimeve ujore realizohet nga AMBU në nivel qendror së bashku me njësitë e saj të varësisë Zyrtare të Administrimit të Baseneve Ujore (ZABU). Funkcionet e organeve të menaxhimit të burimeve ujore lidhen me mbrojtjen e burimeve ujore si nga pikëpamja sasiore edhe ajo cilësore. Veç detyrimeve të cilat përcaktohen në kuadrin ligjor e rregullator mbi menaxhimin në tërësi të burimeve ujore AMBU ka disa detyrime që lidhen me ujin e pijshëm të ambalazhuar të cilat rrjedhin nga rregullorja për ujin<sup>14</sup> dhe VKM nr. 550, datë 15.07.2020 e cila përcakton kriteret për aplikimin dhe dhënien e lejeve/autorizimeve për përdorim të burimit ujor. Kjo kryesisht në procesin e pajisjes pajisjen me leje apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore monitorimin e kushteve të lejeve të dhëna, në rastin kur qëllimi i përdorimit të

<sup>13</sup> Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, neni 11, pika 5;

<sup>14</sup> VKM nr. 379, date 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e Ujit të pijshëm”.

tyre është për ujë të pijshëm apo ujë të ambalazhuar. Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të cilat lidhen me burimet e ujit të pijshëm nga AMBU janë:

- planifikon, zbaton, ndjek, garanton optimizimin e përdorimit të burimeve njerëzore, materiale, aseteve të nevojshme për kryerjen e proceseve të punës për menaxhimin e burimeve ujore;
- realizon të gjitha proceset e punës, pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, si dhe bashkërendon e kontrollon punën e zyrave të administrimit të baseneve ujore.
- realizon projektimin, ekzekutimin, vënien në punë dhe shfrytëzimin e produkteve të kërkuara, si dhe garanton cilësinë, certifikon, lëvtron dhe akumulon përfitimet e produktit të realizuar;
- ndjek dhe monitoron zbatimin e kushteve e të kriterëve të përcaktuara në lejet/autorizimet e dhëna për përdorimin e ujit, si dhe ndërmerri masat ndaj subjekteve që gjenden në shkelje;
- i propozon K KU-së dhe/ose KBU-së rishikimin, pezullimin, shfuqizimin ose anulimin e lejeve, autorizimeve;
- siguron mbledhjen e të ardhurave nga tarifat e përdorimit të ujit dhe pagesat për shpenzimet administrative, nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore apo marrëveshje me të tretë dhe i derdh në buxhetin e shtetit.
- mbledh, strukturon, përpunon, akseson dhe administron të dhëna sasiore e cilësore mbi burimet ujore dhe i vë ato në dispozicion të institucioneve në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

### 3.4 Pesha në buxhet

Institucionet objekt auditimi kanë një fokus të gjerë në veprimtarinë e tyre, sa i përket veprimtarive inspektuese, kontrolluese, monitoruese sa i përket treguesve buxhetorë nuk kanë arritur të paraqesin një ndarje të shpenzimeve në mënyrë specifike të cilat lidhen me pjesën e ujit të pijshëm të ambalazhuar. Veç shpenzimeve buxhetore disa prej institucioneve krijojnë të ardhura këto lidhur me shfrytëzimin e burimit ujor apo dhe tarifat e kryera për licencimet/përdorimet e nevojshme. Sipas të dhënave të paraqitura më poshtë evidentohen të vlerat e arkëtuara nga ana e AMBU për vitet 2020-2024 të cilat i referohen arkëtimeve mbi shfrytëzimin e burimit ujor për ujë të pijshëm të ambalazhuar si dhe treguesit për vlerat e arkëtuara për analizat e kryera nga ana e NJVKSH Tiranë, si njësi më e madhe vendore në vend e kujdesit shëndetësor, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 1 Të dhëna mbi të ardhurat e mbledhura nga AMBU në vitet 2020-2024.

| <i>Në lekë</i> |  |                 |
|----------------|--|-----------------|
| Viti           | Vlerat e arkëtuara nga tarifat për burimet e ujit të përdorur pijshëm të ambalazhuar | Subjekte pagues |
| 2020           | 7 412 389  | 30              |
| 2021           | 7 310 428  | 32              |
| 2022           | 7 353 865  | 35              |
| 2023           | 7 765 370  | 36              |
| 2024           | 9 677 560  | 39              |
| <b>Shuma</b>   | <b>39 519 612</b>  |                 |

*Burimi: AMBU, përpunuar nga Grupi i Auditimit*

Të ardhurat krijohen edhe nga institucione si AKU dhe ISHP, të cilat nuk kanë arritur të përcjellin treguesit e plotë në nivel kombëtar mbi të ardhurat që arkëtojnë.

Tabela nr. 2 Të ardhurat të mbledhura nga NJVKSH Tiranë për vitet 2020-2024.

*Në lekë*

| Viti         | Vlerat e arkëtuara nga pagesat për analizat e ujit të pijshëm të ambalazhuar |
|--------------|--|
| 2020         | 527 640  |
| 2021         | 3 248 290  |
| 2022         | 6 636 384  |
| 2023         | 375 820  |
| 2024         | 3 642 710  |
| <b>Shuma</b> | <b>14 430 844</b>  |

*Burimi: NJVKSH Tiranë, përpunuar nga Grupi i Auditimit*

### 3.5 Feedback-u i subjekteve përgjatë gjithë auditimit

Gjatë të dyja fazave të auditimit, fazës studimore dhe fazës së terrenit institucionet, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me njësitë e saj të varësisë, Institutin e Shëndetit Publik dhe Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me njësinë e saj të varësisë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit si dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese si edhe plotësimit të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar. Disa vonesa janë evidentuar nga ana e AKU gjatë fazës studimore por në vijim komunikimi ka vazhduar në mënyrë të rregullt.


## 4. DETAJET E AUDITIMIT

### 4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë risqet e katër fushave në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht për (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet). Analiza SWOT është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin, dhe vlerësimin e funksionimit të një institucioni apo procesi të caktuar. Ajo mundëson gjendjen aktuale të subjekteve nën auditim, për të diagnostikuar problemet. Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë rrisht ka karakter paraprak dhe në vazhdimësi të auditimit, nëse do të jetë e nevojshme, do të kryhet një rivlerësim dhe/ose përditësim i risqeve të identifikuara. Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Duke iu referuar kësaj analize, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Fig.2 Analiza SWOT



Burimi: Grupi i auditimit

Tabela. 3: Analiza e Riskut

| Nr. | Risku i Subjektit   | Kategorizimi i riskut               | Niveli i Riskut |
|-----|---|-------------------------------------|-----------------|
| 1   | Mos përfshirja e “ujit të pijshëm të ambalazhuar” në dokumentet politikë të miratuar.                   | <b>Risk Strategjik</b>              | I lartë         |
| 2   | Masa të pamjaftueshme për mbrojtjen e burimeve ujore.   |                                     | I lartë         |
| 3   | Numri i lartë i institucioneve të përfshira në zinxhirin e proceseve për ujin e pijshëm të ambalazhuar. |                                     | I lartë         |
| 4   | Konflikti i interesit në përgjegjësinë shtetërore.  |                                     | I lartë         |
| 5   | Përdorim jo i përshtatshëm i kapaciteteve dhe infrastrukturës shtetërore.                               | <b>Risk Financiar</b>               | I lartë         |
| 6   | Gjenerimi i të ardhurave që vilen nga proceset.   |                                     | I mesëm         |
| 8   | Mungesa e përditësimit të kudrit ligjor dhe rregullator   | <b>Risk Rregullator dhe Juridik</b> | I mesëm         |
| 9   | Mbivendosje e roleve dhe përgjegjësisë të institucioneve të përfshira.                                  | <b>Risk Operacional</b>             | I mesëm         |


|           |   |         |
|-----------|---|---------|
| <b>10</b> | Koordinim i pamjaftueshëm mes institucioneve.   | I lartë |
|           | Kontrolle të pamjaftueshme nga institucionet  | I lartë |
| <b>11</b> | Infrastrukturë laboratorike e pamjaftueshme, në funksion të përgjegjësisë institucionale. | I lartë |
| <b>12</b> | Mungesë e transparencës me publikun   | I lartë |

*Burimi: Grupi i Auditimit*

#### **4.2 Objektivi i auditimit**

Auditimi me temë "Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin", kishte si objektiv kryesor vlerësimin e veprimtarive të institucioneve përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre, lidhur me garantimin e cilësisë së ujit që hidhet në treg për qytetarin. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëpërmjet identifikimit të mangësive, shkallën e zbatimit të standardeve dhe propozimin e masave korrigjuese për të përmirësuar proceset me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

### 4.3 Pyetjet e auditimit



#### **4.4 Fushëveprimi i auditimit**

Ky auditim kishte si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinionimi mbi mirë administrimin e proceseve me synim marrjen e masave të përshtatshme. Auditimi kishte një qasje në nivel sistemi duke e parë nga perspektiva e detyrimeve që subjektet nën auditim kanë për garantimin e cilësisë së ujit të pijshëm që tregtohet, në bazë të fushës së tyre të përgjegjësisë shtetërore. Kjo sa i përket proceseve për dhënien e lejeve/miratimeve të nevojshme, kryerjen e analizave laboratorike, kontrollet/monitorimet që realizohen përgjatë proceseve, bashkëveprimin mes institucioneve si dhe informimin dhe transparencën për qytetarin. Periudha e auditimit ishte nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2024. Gjatë këtij auditimi u fokusuar në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me njësitë e saj të varësisë, Institutin e Shëndetit Publik, Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me njësitë e saj të varësisë, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe disa drejtori rajonale si dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Subjektet e përzgjedhur si edhe periudha e auditimit ishte për të pasur një panoramë më të plotë lidhur me kompetencat dhe proceset që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të mirë menaxhimit dhe sigurisë për qytetarin.

### **5. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT**

**Pyetja kryesore: A siguron sistemi i ngritur cilësinë e ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin ?**

#### **Mesazhi i auditimit**

Sistemi i ngritur nuk ka arritur të garantojë qytetarin për cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar që hidhet në treg. Megjithatë konsumi i këtij produkti ka pësuar rritje të vazhdueshme çdo vit, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të përmbushin plotësisht detyrimet e tyre sa i përket kontrollit, monitorimit e analizimit të tij. Ndryshimet e kompetencave në strukturat shtetërore, kanë krijuar paqartësi në rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe kanë ndikuar në funksionimin e fragmentuar të sistemit. Kuadri ligjor e rregullator paraqitet i pa harmonizuar dhe në disa raste kontradiktor, nuk mundëson konkurrencë mes projekteve për përdorimin e burimit ujor dhe ka kriteret e dobëta për dhënien e lejeve dhe licencave. Nga ana tjetër, mangësitë e institucioneve në drejtim të, analizimeve laboratorike, bashkëveprimeve ndër-institucionale si dhe informimit të publikut, nuk kanë garantuar cilësinë e ujit të ambalazhuar dhe sigurinë e nevojshme për qytetarin.

**5.1 Pyetje e auditimit: A ndiqen procedurat e duhura për prodhimin dhe certifikimin e ujit të ambalazhuar ?**

*Në strategjinë kombëtare për burimet ujore nuk ka tregues për ujin e pijshëm të ambalazhuar dhe mungon një vizion i qartë mbi fokusin për të ardhmen e këtij sektori.*

Uji është burim natyror strategjik për Shqipërinë! Ky është motivi kryesor i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027<sup>15</sup>, miratuar në vitin 2018. Kjo është strategjia ku përcaktohen në mënyrë të përgjithshme sfidat për furnizimin me ujë në funksion të shtyllës së parë “ujë për njerëzit”.

<sup>15</sup> Miratuar me VKM nr. 73 datë 07.02.2018.

Sipas strategjisë, në vitet në vijim vendi mund të përballet me ndryshime klimatike të cilat do të kenë ndikim në uljen e prurjeve të burimeve ujore rreth 14% deri në vitin 2050. Strategjia integron katër shtylla për menaxhimin e ujit ku përmenden:

- ✓ ujë për njerëzit,
- ✓ ujë për shqim,
- ✓ ujë për mjedis,
- ✓ ujë për energji.

Në të përcaktohen disa objektiva kryesorë sa i përket, sigurimit të përdorimit të drejtë dhe të qëndrueshëm të burimeve ujore; sigurimi i cilësisë së mirë të ujit; menaxhimi i investimeve për tu siguruar nga rreziqet; sigurimin e modeleve dhe të dhënave të besueshme për të gjitha palët e interesit si dhe menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Në vendin tonë tetë pellgjet ujëmbledhës janë grupuar në shtatë njësi hidrografike, të cilat njihen si basenet ujore. Lumenjtë Drini-Buna, Lumi Mati, Lumenjtë Ishëm dhe Erzeni, Lumi Shkumbin, Lumi Seman dhe Lumi Vjosa janë pjesë e secilit basen sipas kufijve të përcaktuar në vendim<sup>16</sup>.

1. Baseni ujqor Drin-Bunë, me qendër në Shkodër;
2. Baseni ujqor Mat, me qendër në Lezhë;
3. Baseni ujqor Ishëm, me qendër në Durrës;
4. Baseni ujqor Erzen, me qendër në Tiranë;
5. Baseni ujqor Shkumbin, me qendër në Elbasan;
6. Baseni ujqor Seman, me qendër në Fier;
7. Baseni ujqor Vjosë, me qendër në Vlorë.

Në çdo basen ujqor funksionon Këshilli i Basenit Ujqor i cili është organ kolegjqal dhe ka si Kryetar Prefektin e Qarkut dhe në përbërje përfaqësues nga bashkitë, institucionet lokale ku përmendim drejtoritë, për mjedisin, zonat e mbrojtura, shërbimet shëndetësore vendore, ujqitjes e kullimit si dhe grupe të interesit për mbrojtjen e burimeve, furnizimin me ujë, për energjinë dhe industrinë.


Në strategjinë e sipërcituar produkti ujë i ambalazhuar nuk analizohet i veçuar, nuk ka tregues mbi zhvillimin e këtij sektori prodhimi, mbi trendin e import-eksportit për të dhe në tërësi nuk ka një vizion të qartë mbi fokusin që duhet të ketë në të ardhmen në këtë drejtim. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT<sup>17</sup> aktiviteti në drejtim të prodhimit të ujqit të ambalazhuar në vitin 2023 ka arritur mbi 382 milion litra. Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjqithshme e Doganave, mbi importet dhe eksportet e kryera gjatë periudhës vitet 2020-2024 flasin për një trend gjithashtu për rritje të theksuar të sasive të ujqit të eksportuar krahasuar me pesë vite. Rritje kanë pësuar edhe sasitë e importuara të ujqit. Pra tregu i ujqit të ambalazhuar është zhvilluar në të dyja drejtimet.

---

<sup>16</sup> VKM nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në republikën e shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre”.

<sup>17</sup> <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/anketa-e-produkteve-industriale-prodcom/publikime/2024/anketa-e-produkteve-industriale-prodcom-2023/>


Grafiku nr. 1



Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit.

Në bazë të treguesve të DPD ambalazhet e importuara në pjesën dërrmuese të tyre janë ambalazhe plastike dhe rreth 1/10 e tij e zë përdorimi i shisheve të qelqit. Treguesit paraqesin nevojën për analizime më të hollësishme mbi kujdesin që nevojitet për mbrojtjen e burimeve ujore dhe zhvillimin e politikave të cilat lidhen me këtë produkt.

Grafiku nr. 2



Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit.

### ***Dy nga Basenet Ujore nuk kanë Plane Menaxhimi të miratuar.***

Planet e menaxhimit të baseneve ujore hartohen dhe zbatohen për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, mbrojtjen e ekosistemeve dhe garantimin e cilësisë së ujit për nevojat e qytetarëve dhe ekonomisë. Në to identifikohen trupat ujorë, në bazë të klasifikimit të ujërave të tyre ku përfshihen edhe akuiferët për përdorim për ujë të pijshëm. Planet ndihmojnë në parandalimin e ndotjes, degradimit të habitateve ujore dhe shfrytëzimit të tepruar të ujit, duke vendosur masa për ruajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e tij në mënyrë të drejtë dhe efikase. Përmes tyre, synohet të ndërtohet një balancë mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së burimeve natyrore, duke respektuar kornizat ligjore dhe standardet mjedisore. Hartimi i tyre është një detyrim i përcaktuar në kuadrin ligjor. Ato duhet të rishikohen çdo gjashtë vite referuar dinamikave ekonomike e sociale të zhvillimit dhe situatës së shfrytëzimit. Deri në fund të vitit 2024 janë të miratuar pesë plane menaxhimi si më poshtë vijon:

1. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Drin-Bunë 2021-2026 (VKM nr. 849, datë 04.11.2020)
2. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Seman 2021-2026 (VKM nr. 453, datë 10.06.2020)
3. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Mat 2024-2029 (VKM nr. 833, datë 28.12.2023)
4. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024-2029 (VKM nr. 624, datë 8.11.2023)
5. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Erzen 2024-2029 (VKM nr. 623 datë 8.11.2023)

Për tre nga basenet e mësipërm miratimi i planeve të menaxhimit thuhet nuk ka pasur efekt pasi ato kanë funksionuar për vetëm disa muaj. Për Basenet Ujore Shkumbin dhe Vjosë nuk ka pasur një plan menaxhimi të miratuar. Ligji i ri i cili ka hyrë në fuqi në Tetor 2024 kërkon përshtatjen e planeve referuar kërkesave<sup>18</sup> të tij. Në të përcaktohet se AMBU publikon planet e menaxhimit të baseneve ujore brenda një afati prej nëntë vitesh nga hyrja në fuqi. Gjithashtu po ky institucion ngarkohet të hartojë elementët që përmban plani i menaxhimit dhe ose përditësimi i tij, si dhe rishikojë dhe përditësojë planet brenda 15 vitesh nga hyrja në fuqi e ligjit dhe çdo gjashtë vite në vijim. Nisur nga ecuria e deritanishme, afatet e reja mjaft të gjata të vendosura për këtë institucion krijojnë risk, lidhur me përshtatshmërinë dhe efektivitetin e vetë kritereve që do të përdoren nga AMBU për këto plane si dhe përmbushjen në një kohë të arsyeshme të miratimit dhe publikimit të tyre me qëllim përdorimin e vlefshëm.

### ***Kufijtë e zonave të mbrojtjes higjieno -sanitare të burimeve ujore nuk janë të përcaktuara.***

Zonat e mbrojtjes higjieno -sanitare duhet të përcaktohen rrotull burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore të ujit, me qëllim që të ruhet cilësia e ujit të burimeve. Sipas ligjit efektiv për burimet ujore deri më Tetor 2024<sup>19</sup> parashikohen tre zona të detyrueshme të si më poshtë:

- a) zona e parë e mbrojtjes rrotull burimit, që kontrollohet nga operatori që nxjerr, prodhon dhe shpërndan ujë të pijshëm. Kjo zonë rrethohet;
- b) zona e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës ndalohen ndërtimet, zhvillimi i industrisë, kryerja e veprimtarive bujqësore e blegtorale, hapja e puseve, hapja e kanaleve, depozitimi apo shkarkimi i ndotjeve, i ujërave të ndotura, i substancave kimike e toksike, përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, përdorimi si varrezë apo groposja e kafshëve të ngordhura;
- c) zona e mbrojtjes së largët, brenda së cilës veprimtaritë e parashikuara në shkronjën “b”.

Kufijtë e tyre duhet të miratoheshin nga Këshilli i Ministrave pas propozimit prej ministrave përgjegjëse për ekonominë, shëndetësinë, punët publike. Këto zona nuk janë miratuar. Ligji i ri hyrë në fuqi më Tetor 2024, përcakton tre zona mbrojtje, kufijtë e të cilave nuk janë ende të miratuara.

<sup>18</sup> Neni 53 i ligjit nr. 29/2024 “Për burimet ujore”.

<sup>19</sup> Neni 34 dhe 57, pika të Ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;

Ndërkohë një akt tjetër që përcakton gjithashtu rregulla mbrojtëse për burimet pikërisht Rregullorja<sup>20</sup> “Cilësia e ujit të pijshëm” e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ajo përcakton disa rregulla për mbrojtjen sanitare kryesisht për ujësjellësit ndërsa për burimet ujore individuale këtë gjë e ngarkon drejt subjekteve kërkues të cilët duhet ti drejtohen Shërbimit Gjeologjik Shqiptar apo një subjekti të licencuar në fushën e hidrogeologjisë, për përcaktimin e zonave të mbrojtjes sanitare me shpenzimet e tyre.

Nga ana tjetër, studimi hidrogeologjik dhe oponenca e tij nga SHGJSH nuk është një detyrim për aplikantët për leje përdorimi të burimit ujor për ambalazhim, me kapacitet më pak se 150 shishe/orë ose 1 litër/sek. Mungesa e miratimit të kufijve përkatës krijon risk për mos përmbushje të detyrimeve nga ana e përdoruesve të burimeve dhe mos mbrojtje të përshtatshme të burimit dhe cilësisë së ujit në të. Prej Tetorit 2024 këto zona duhet të miratohen me VKM bazuar në propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë pas përcaktimit të tyre nga AMBU në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse.


**Procesi i dhënies së lejeve për përdorim të burimit ujor paraqet mangësi.**

Burimet ujore mund të përdoren për disa qëllime ku përmendim, përdorim vetjak, bujqësi, turizëm, transport ujor, akuakulturë, tregti etj. Ligji 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, si qëllim ka pasur mbrojtjen, sigurimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore. Çdo subjekt sipas formave të organizimit në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare që ofron/shet në publik ujë të pijshëm duhet të jetë i pajisur me leje apo autorizim si dhe të përmbushë kërkesat e parashikuara për cilësinë e tij. Edhe ligji i ri nr. 29/2024 “Për burimet ujore” i hyrë në fuqi në fundin e muajit Tetor 2024, ndjek thujtë të njëjtën linjë sa i përket parimeve të përdorimit të burimeve ujore.

Sipas të dhënave të AMBU deri në fund të vitit 2024 janë të regjistruara 52 leje përdorimi të burimeve ujore të miratuara për ujë të pijshëm të ambalazhuar të cilat u përkasin 41 subjekteve tregtarë. Nga këto, 14 prej tyre janë me kontratë koncesioni që datojnë në vitet 2004 deri 2008 me afat vlefshmërie rreth 30 vite. Lejet/autorizimet e tjera kanë një afat vlefshmërie prej 5 vitesh sipas vendimeve të marra nga Këshillat e Baseneve Ujore përkatëse.

Lejet për përdorim burimi për ujë të ambalazhuar sipas basenit ujor paraqiten si më poshtë.


Grafiku nr. 3



Burimi: AMBU, përpunuar nga grupi i auditimit.

<sup>20</sup> VKM nr. 379 datë 25.05.2016 Rregullorja “Cilësia e ujit të pijshëm”;

Veç lejeve të mësipërme gjatë periudhës vitet 2020-2024 janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme 2 kontrata koncesionare me vendim të KBU Vjosë, ndërsa nga ana e KBU Shkumbin-Seman është kryer një pezullim leje. Të tre vendimet janë marrë në fund të vitit 2020. Pozicionimi i lejeve të miratuara për ujë të ambalazhuar sipas baseneve ujorë paraqitet si vijon:



Burimi: AMBU, përpunuar nga grupi i auditimit.

Procesi i aplikimit për leje përdorimi të burimit ujq në rastet kur nuk janë objekt i dhënies së koncesionit kryhet nëpërmjet platformës *e-albania*,<sup>21</sup> e cila administrohet nga AKSHI. Ndërkohë AMBU në këtë proces luan rolin e sekretariatit teknik i cili pasi shqyrton formalisht përmbushjen e dokumentacionit të aplikimit kryen shqyrtimin e tij dhe e përcjell atë tek Këshillat e Baseneve Ujqore për miratim. Këta të fundit si organe kolegjiale me pjesëmarrje të përbërë nga disa institucione e njësi vendore bëjnë miratimin përfundimtar të lejes. Lejet kanë afat 5 vjeçar me të drejtë rinovimi sipas një procedure të veçantë. Më tej ato përcillen drejt Qendrës Kombëtare të Biznesit për tu publikuar në regjistrin e lejeve dhe licencave.

-Për të kryer aplikimin për leje përdorimi për ujë të ambalazhuar në VKM nr. 550 datë 15.07.2020, janë miratuar dy formularë standard, të cilët përcaktojnë dokumentacionin që duhet të paraqesin subjektet tregtare për përfitimin e saj.

*Formulari nr.3 Kërkesë për leje për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për ujë të ambalazhuar.*

*Formulari nr.21 Kërkesë për leje për përdorim burimi ujq nëntokësor për ujë të ambalazhuar.*

Formulari nr. 3 i saj është për subjekte të cilat kërkojnë të pajisen me leje për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për ujë të ambalazhuar. E njëjta gjë vihet re edhe në vendimin<sup>22</sup> i cili rregullon tarifat në të cilin përcaktohen gjithashtu tarifa për përdorimin e burimi ujq sipërfaqësor për ujë të ambalazhuar. Ndërkohë që Rregullorja “Cilësia e ujit të pijshëm”, në nenin 8 të saj përcakton se, ndalohet ambalazhimi i ujërave me origjinë sipërfaqësore, qofshin edhe të trajtuara. Pra të tre vendimet paraqesin kundërshtim mes tyre dhe krijojnë premisa për interpretime të gabuara nga ana e strukturave të AMBU.

Nga të dhënat e regjistrit elektronik në një rast leja për përdorim i referohet ujit sipërfaqësor. Sipas dokumentacionit të paraqitur, ajo rezulton me pasaktësi, pasi referuar oponencës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar marrja e ujit i përket një burimi nëntokësor. Përkatësisht për burimin ujq në Basenin Ujq Mat si vijon:

Tabela nr.4 Leje ambalazhimi e zbardhur gabim

| Leje/Autorizim | Baseni Ujq | Nr. Vendim KBU | Dt. Vendim leje/autorizim | Seriali | Filluar aktivitetin | Lloji i aktivitetit dhe qëllimi i përdorimit përcaktuar në Leje               |
|----------------|------------|----------------|---------------------------|---------|---------------------|---|
| LEJE           | Mat        | 4              | 18.01.2019                | 27      | Viti 2019           | Për ambalazhim uji në shishe ose enë, duke përdorur burimin ujq sipërfaqësor. |

*Burimi: AMBU, përpunuar nga grupi i auditimit*

Rregullorja e ujit trajton vetëm ujërat nëntokësore për ambalazhim dhe jo ata sipërfaqësorë. Sa trajtuar edhe më sipër, mospërputhjet midis dispozitave të vendimeve për rregulloren e ujit dhe miratimin e formularëve për marrjen e lejes krijojnë paqartësi lidhur me procedurat që ndiqen.

-Në katër raste evidentohen leje të miratuar për transport/tregti me bot uji. Ndërkohë që rregullorja për ujin e përcakton qartë përdorimin e botit vetëm në raste emergjencash ose në disa situata kur kjo mënyrë furnizimi është e vetmja mundësi e vlefshme. Në të përcaktohet mënyra si duhet të monitorohet ky proces nga strukturat përkatëse të shëndetit publik dhe miratimet e lejeve higjieno-sanitare për mjetet që do të përdoren. Procesi i transportimit me autobot ndodhet jashtë mbulimit të organeve që garantojnë sigurinë shëndetësore dhe ushqimore. Kjo pasi, NJVKSH-të nuk kryejnë verifikime në terren por edhe AKU i kryen inspektimet nëpërmjet një procesi të parapërcaktuar. Kjo mënyrë operimi në treg nuk duhet të

<sup>21</sup> pika 29 e VKM nr. 550 datë 15.07.2020;

<sup>22</sup> VKM nr. 993 datë 09.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkufitare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre”;

bëhej një formë e zakonshme por një zgjidhje në kushtet e emergjencës si parashikohet në aktet rregullatorë. Në këto kushte vijueshmëria për një periudhë të gjatë e këtij lloji aktiviteti krijon/mund të krijojë ekspozim të qytetarit ndaj problematikave që mund të lindin me jokonformitetin e produktit që furnizohet. Tabela si më poshtë.

Tabela nr.5 Leje ambalazhimi me BOT

| Leje/Autorizim | Baseni Ujor | Nr. Vendim KBU | Dt. Vendim leje/autorizim | Seriali | Filluar aktivitetin | Lloji i aktivitetit dhe qëllimi i përdorimit përcaktuar në Leje |
|----------------|-------------|----------------|---------------------------|---------|---------------------|---|
| LEJE           | Seman       | 6              | 24.02.2022                | 32      | Viti 2017           | Për tregtim me enë (Bot uji)                                    |
| LEJE           | Seman       | 8              | 24.3.2022                 | 53      | Viti 2017           | Për ujë të ambalazhuar me (Bot)                                 |
| LEJE           | Seman       | 5              | 24.3.2022                 | 50      | viti 2009           | Për ujë të ambalazhuar me (Bot)                                 |
| LEJE           | Shkumbin    | 2              | 04.07.2022                | 68      | Viti 2017           | Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar (me bot) |

*Burimi: AMBU, përpunuar nga grupi i auditimit*

-Në disa prej lejeve konstatohet se sasia e ujit të dhënë në përdorim është e njëjtë sa prurja mesatare vjetore e burimit nëntokësor. Nuk evidentohet të ketë një përcaktim të qartë në VKM se sa duhet të jetë prurja e shfrytëzueshme në këto raste. Megjithëse formulari i lejes për ujërat nëntokësorë përcakton se prurjet mesatare, ekologjike dhe sasia e ujit që do të përdoret përshkruhet në litra/sek, në disa prej lejeve ajo vendoset në M3.

Konstatohet gjithashtu se, procesi i regjistrimit të lejeve në regjistrin e QKB dhe publikimi i tyre dërgohet manualisht nga AMBU, çka krijon premisa për mos përmbushje në kohë të publikimit të lejes.

Vendimmarrjet e përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse në Këshillat e Baseneve Ujore për miratimin e lejeve të përdorimit për burimet ujore realizohen nëpërmjet sistemit informatik. Pjesa dërrmuese e tyre thuajse në të gjitha rastet i miraton në heshtje, pa mendim të shprehur pro ose kundër, çka nuk garanton kryerjen e një analizë të thellë sipas funksioneve përfaqësuese në këshill.

#### ***Modeli aktual nuk mundëson konkurrencën mes projekteve për shfrytëzimin e burimit ujor.***

Për dhënien në përdorim të një burimi ujor i cili është pasuri kombëtare kuadri ligjor e rregullator nuk mundëson konkurrencën e drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Mungojnë kriteret përzgjedhëse dhe/ose krahasuese për përfitimin e të drejtës së përdorimit dhe përzgjedhjen mes alternativave. Ndërkohë kriteret e kërkuara janë thuajse minimaliste. Kërkesat lidhur me performancën financiare të subjektit, pastërtinë e figurës së përfaqësuesit ligjor të tij dhe/ose ortakëve, apo dhe kriteret të cilat janë të nevojshme për një procedurë të zakonshme prokurimi publik nuk janë pjesë e procedurës. Gjithçka lihet në diskrecionin e subjektit kërkues i cili paraqet raporte, studime analiza nga ekspertë të fushës të përzgjedhur dhe të cilët paguhen prej tij. Nga ana tjetër AMBU e cila luan rolin e propozuesit për vendimmarrjet nga këshillat e baseneve dhe merret me shqyrtimin e dosjeve të aplikimit nuk disponon kapacitetet e mjaftueshme për kryerjen e një vlerësimi të plotë tekniko-ekonomik dhe ligjor të aplikimeve, oponencën e nevojshme lidhur me veprën e marrjes së ujit dhe zgjidhjen teknike e industriale që do të përdoret.


Në rastet kur përfundon leja e miratuar dhe kërkohet rinovimi i saj praktika e miratuar ndjek një proces më të thjeshtuar. Sipas Formularit nr. 45 kërkohen vetëm raportet e monitorimit, vetë monitorimit, si dhe një pjesë më e kufizuar e analizave, tashmë jo nga ISHP/SRSHP por nga laboratorë të akredituar. Analizat e ujit në burim, krahasimi i rezultateve me propozimin fillestar të veprës, numrin e punonjësve, problematikat në treg lidhur me rastet jo konform të evidentuara apo të tjera çështje të cilat janë me interes për garantimin e cilësisë së produktit

nga prodhuesit. Modeli aktual pa filtrat e nevojshëm verifikues nuk garanton që propozimi i bërë përbën alternativën më të mirë për shfrytëzimin e burimit ujor.

**Struktura e AMBU paraqet vakanca të vazhdueshme në staf.**

Vendimi mbi organizimin dhe funksionimin<sup>23</sup> e AMBU përcakton ngritjen e strukturave në nivel qendror dhe degë të saj, në nivel baseni ujor. Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore ngrihen në përputhje me basenet ujore të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Sipas strukturës deri në fund të vitit 2024 rezultojnë të ngritura 4 degë të saj, për 7 basene ujore të miratuar. Këto degë e ushtrojnë veprimtarinë në basenet ujore të grupuar përkatësisht:

1. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor, Drin-Bunë;
2. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor, Ishëm-Erzen-Mat;
3. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor, Shkumbin-Ishëm;
4. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë.



*Burimi: AMBU*

Evidentohet se, gjatë pesë viteve të fundit vitet 2020-2024, AMBU me strukturat e varësisë kanë pasur një numër të konsiderueshëm vendesh pune të paplotësuar sipas strukturës së miratuar për AMBU qendër dhe strukturat vendore.

<sup>23</sup> VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, Kreu II. Pika1;

Këto mungesa kanë vijuar përgjatë gjithë periudhës. Në disa struktura vendore mungesat e stafit shkon në rreth 50% të mungesave në staf. Për periudhën vitet 2020-2023 pozicioni i titullarit të institucionit ka qenë vakant, pra pa emërim.

Tabela nr.6

| Struktura                | Nr. Punonjësish në strukturë 2020/01-2023/08 | Nr. Punonjësish në strukturë 2023/09-2024/12 | Vakancat më 31.12.2020 | Vakancat më 31.12.2021 | Vakancat më 31.12.2022 | Vakancat më 31.12.2023 | Vakancat më 31.12.2024 |
|--------------------------|--|--|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| AMBU                     | 43   | 42   | 15                     | 12                     | 12                     | 10                     | 10                     |
| ZABU Drin - Bunë         | 9  | 9  | 2                      | 0                      | 0                      | 0                      | 0                      |
| ZABU Ishëm - Erzen - Mat | 11   | 11   | 1                      | 2                      | 3                      | 3                      | 5                      |
| ZABU Shkumbin - Seman    | 11   | 11   | 6                      | 5                      | 8                      | 8                      | 2                      |
| ZABU Vjosë               | 9  | 9  | 0                      | 2                      | 4                      | 4                      | 4                      |
|                          |  |  |                        |                        |                        |                        |                        |
| <b>Gjithsej</b>          | <b>83</b>                                    | <b>81</b>                                    | <b>24</b>              | <b>21</b>              | <b>27</b>              | <b>25</b>              | <b>21</b>              |

Burimi: AMBU, përpunuar nga grupi i auditimit.

Ndër strukturat e prekura me vende të paplotësuara janë edhe sektorët përgjegjës për lejet dhe monitorimit të përbushjes së tyre. Funkcionet e sekretariatit teknik të KBU-së ushtrohen gjithashtu nga ZABU përkatëse. Ndërkohë që ato mbulojnë një territor që përfshin disa basene ujore dhe kanë disa detyra të ndërlidhura lidhur me burimet ujore. Mosplotësimi i këtyre pozicioneve të punës për një kohë të gjatë krijon risk të lartë për përbushjen e objektivave dhe detyrave specifike nga këto struktura.

#### ***Faturimet e ujit të burimit realizohen në periudha 3 mujore dhe jo mujore.***


Pas marrjes së lejes së përdorimit për burimin ujor strukturat e AMBU kryejnë monitorimet lidhur me sasitë e ujit të përdorur, sipas leximit të matësve. Kjo praktikë pune është e përcaktuar në procedurat e brendshme të punës të ZABU-ve përkatësisht, për dy sektorët e ngarkuar për leximin e matësve dhe çështjet ekonomiko-financiare. Sipas proceseve të përcaktuara në këtë dokument si dhe përgjigjeve të dhëna nga AMBU evidentohet se, faturimet e ujit nga ana e strukturave të AMBU kryhen mbi baza tre mujore. Ndërkohë që tarifat e ujit sipas llojit të lejes përcaktohen me një vendim<sup>24</sup> të posaçëm të Këshillit të Ministrave. Pavarësisht se faturimi kryhet mbi bazë volumi të përdorur duhet të ndjekë rregullin e përgjithshëm mbi faturimin në vend, i cili bazohet në faturimin mujor dhe raportimin vjetor sipas ligjit për buxhetin<sup>25</sup>. Ndërkohë edhe subjektet tregtare të cilët i nënshtrohet legjislacionit fiskal<sup>26</sup> duhet të raportojnë kostot si edhe lëndët e para me qëllim rishitje mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në periudha mujore dhe vit ushtrimor. Lidhur me procesin e faturimit nuk evidentohen bashkëveprime nga ana e AMBU me institucione të tjera shtetërore për kryqëzimin e informacionit sa i përket sasive të ujit të shitur nga ana e prodhuesve dhe përkatësisht, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Të dhënat e faturimit sipas baseneve ujore paraqiten si më poshtë vijon:

<sup>24</sup> VKM nr. 93, datë 9.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkuftare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre”,

<sup>25</sup> Neni 39 i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Përmenaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>26</sup> Neni 101 i ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Grafiku nr. 4



*Burimi AMBU, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Nga ana e AMBU për vitet 2020-2024 janë faturuar rreth 3.7 milion m<sup>3</sup> ujë burimi me një vlerë faturimi rreth 44.5 milion lekë. Sipas të dhënave të paraqitura në vitin 2024, faturimet i përkasin vetëm 36 subjekteve. Ndërkohë një pjesë e tyre nuk paraqiten me konsum. Për vitet 2020-2024 janë zgjidhur kontratat me dy subjekte. Referuar të dhënave më sipër evidentohet se, ndryshe nga të gjithë basenet e tjerë stabilimentet e mbuluara nga ZABU Shkumbin-Seman paraqiten thuajse të përgjysmuara krahasuar me pesë vite më parë. Kjo strukturë ka pasur mungesa të theksuara në personel kryesisht në vitet 2022 dhe 2023 me rreth 80% të stafit. AMBU lidhur me përmbushjen së kushteve të lejeve disponon procedura të miratuara lidhur me monitorim-kontrollin e tyre. Këto procedura parashikojnë bashkëpunimin me ente publike për të harmonizuar dhe bashkërenduar procesin e monitorim kontrollit të burimeve ujore. Për përmbushjen e objektivave të monitorimit lind nevoja për kryqëzime periodike të informacioneve me institucionet të cilët disponojnë të dhëna sasiore si DPT dhe DPD apo dhe atyre që disponojnë të dhëna të tjera mbi burimet ujore, si dhe marrjen e masave përkatëse.

#### ***Procedura e dhënies së lejes së stabilimentit nga AKU.***


Operatori i biznesit i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit pas marrjes së lejes për përdorim të burimit ujor, duhet të plotësojë infrastrukturën për stabilimentin e prodhimit të ujit sipas projektit të paraqitur. Pas plotësimit të kushteve për prodhim ai duhet t'i drejtohet AKU-së për t'u pajisur me licencën<sup>27</sup> e stabilimentit për prodhimin e ujit të pijshëm të ambalazhuar e cila kategorizohet në "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" kodi (II.I.A.1). Aplikimi për pajisje me licencë bëhet elektronikisht në portalin *e-albania*. Struktura përgjegjëse në AKU pasi shqyrton formalisht kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur e përcjell më tej për verifikim tek strukturat e saj rajonale të juridiksionit pra Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Në vijim nga këto të fundit kryhet inspektim në ambientet e subjektit kërkues nëpërmjet një liste të përcaktuar kërkesash. Me konfirmimin e plotësimit të kërkesave përkatëse tekniko-teknologjike dhe higjieno-sanitare subjektit i lind e drejta për të marrë lejen për stabilimentin e prodhimit. Kjo leje ka afat deri në ndryshimin e drejtuesit teknik apo ndryshimeve të cilat detyrojnë rinovimin e saj. Me kërkesë

<sup>27</sup> Ligji nr. 10081 datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 538 datë 26.05.009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

të operatorëve apo në rast se gjatë kontrolleve të mëposhëm rezulton se nga ana e operatorëve nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara, AKU i propozon ministrit përgjegjës për ushqimin heqjen e licencës.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga ana e AKU për vitet 2009-2024 janë licencuar/ri-licencuar gjithsej 49 stabilimente uji. Numri i stabilimenteve të licencuara ndër vite paraqitet si vijon:

Grafiku nr. 5



Burimi: AKU, përpunuar nga grupi i auditimit.

Miratimi i kushteve për përfitimin e licencave për stabilimentet e ujit nga ana e DRAKU dhe nga ana tjetër monitorimi/inspektimi i tyre për përmbushjen e kushteve të lejes përbën një lloj konflikti interesi në dukje. Kjo pasi të dyja këto veprimtari realizohen nga i njëjti institucion.

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk e ka kusht disponimin e lejes së burimit ujqor për licencimin e stabilimentit të ujit.**

Lidhur me procesin e licencimit për stabilimentet e ujit nga ana e AKU vepohet mbi bazën e “Listë verifikimit për inspektimin e përgjithshëm të higjienës”. Në këtë listë nuk ka asnjë kriter të përcaktuar, nëse operatori ekonomik (subjekti), ka një leje shfrytëzimi burimi ujqor të vlefshme nga organet kompetente për zhvillimin e procesit të ambalazhimit. Gjithashtu, nuk evidentohen kërkesa për tu përmbushur lidhur me kritere tekniko-teknologjike si përcaktohet nenit 19, pika 13 të ligjit për ushqimin. Referuar pyetësorëve, përgjigjeve të dhëna, nga ana e AKU nuk ka asnjë formë bashkëpunimi me AMBU mbi lejet e burimit ujqor. Ndërkohë që bashkëveprimi mes tyre është i domosdoshëm sa i përket vlefshmërisë së lejeve përkatëse dhe jo vetëm. Pra nëse një shoqëri nuk përmbush kriteret për përpunim kjo e dhënë do të ishte mjaft e vlefshme për AMBU. Nëse leja e përdorimit të burimit ujqor mbaron, revokohet, pezullohet

kjo është një vendimmarrje e cila duhet bërë me dije edhe AKU me qëllim pezullimin e lejes së stabilimentit pasi nuk mund të kryhet veprimtari në mungesë të lejes së përdorimit të lëndës së parë.

Gjithashtu aspekt i rëndësishëm midis AMBU-AKU është edhe garantimi i përdorimit i burimit ujqor vetëm për aktivitetin e diktuar nga leja e përdorimit pra atë të ambalazhimit dhe shitjes të ujqit të ambalazhuar. Kjo, që uji të mos përdoret për qëllime të tjera industriale, për të cilat operatori detyrohet të ketë leje të veçantë përdorimi të burimit ujqor. Këto forma bashkëpunimi të domosdoshme mes këtyre institucioneve aktualisht nuk janë të formësuar në ligj apo akte rregullatorë.

### ***AKU vihet në djepi për stabilimentet vetëm pas kërkesës së operatorit.***

Për t'u pajisur me licencë për stabiliment prodhim uji të pijshëm të ambalazhuar AKU kryen inspektimet në kuadër të ligjit për inspektimin dhe Inspektoratit Qendror. Veprimtaritë janë të paracaktuara lidhur me numrin, kohën dhe operatorët ekonomikë objekt i këtyre inspektimeve. Nga ana tjetër të dhënat mbi bizneset e reja me të njëjtin objekt apo edhe të ndryshëm që regjistrohen në vend nuk vijnë në mënyrë të menjëhershme në AKU. Të dhënat mbi regjistrimet merren në QKB në periudha të ndryshme mbi bazë kërkesë. Pavarësisht detyrimit të operatorëve për njoftim në AKU apo marrje leje sipas rastit, pra vetë deklarimit të tyre, kontrolli në territor nga ana e AKU lidhur me veprimtarinë prodhuese në rastin më të mirë kryhet i vonuar në kohë. Mos marrja e informacionit në kohë mbi aktivitetet e reja të hapur, vendndodhjen e njësisë, lista e gjerë e aktiviteteve që operatorët për qëllime të biznesit deklarojnë në QKB, dhe nga ana tjetër veprimtaria e përcaktuar dhe kufizuar inspektuese e këtyre strukturave krijon risk për mosveprim në kohë dhe me efektivitet për garantimin e sigurisë ushqimore lidhur me stabilimentet e ujqit por jo vetëm.

**1. Gjetje nga auditimi:** Hartimi dhe miratimi i planeve të menaxhimit të baseneve ujqore është detyrim i përcaktuar në ligjin e mëparshëm por edhe në ligjin e ri, i cili ka hyrë në fuqi në Tetor 2024<sup>28</sup>. Planet e menaxhimit identifikojnë trupat ujqorë, në bazë të klasifikimit të ujërave të tyre ku përfshihen edhe akuiferët<sup>29</sup> për përdorim për ujë të pijshëm. Planet ndihmojnë në drejtim të parandalimit të ndotjes, degradimit të habitateve ujqore si dhe shfrytëzimit të tepruar të burimeve ujqore. Deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri për burimet ujqore, janë hartuar e miratuar pesë nga shtatë planet menaxhimit të baseneve ujqore. Ndërkohë, për dy basenet ujqore Shkumbin dhe Vjosë nuk ka ende një plan menaxhimi të miratuar. Ligji i ri, kërkon përshtatjen e planeve referuar kërkesave të reja. Në të përcaktohet se, AMBU duhet të hartojë elementët për përmbajtjen e planeve të reja të cilat miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. I njëjti trajton se, planet duhet të publikohen brenda nëntë vitesh nga hyrja në fuqi e ligjit. Për basenet pa një plan menaxhimi të miratuar ndër vite, apo atyre që janë në përfundim të afatit të vlefshmërisë, ky afat është mjaft i gjatë çka nuk garanton mbrojtjen më të mirë të trupave ujqorë.

**2. Gjetje nga auditimi:** Kufijtë e zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare për burimet e ujqit duhet të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit nga disa ministri përgjegjëse. Deri në fund të vitit 2024 kufijtë e këtyre zonave nuk janë miratuar. Me ligjin e ri për burimet ujqore, ato duhet të miratohen me propozim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, por fillimisht duhet që AMBU në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse ti përcaktojnë ato.

<sup>28</sup> Ligji nr. 29/2024, "Për burimet ujqore";

<sup>29</sup> Referuar ligjit, "Akuifer" është një apo disa shtresa nënsipërfaqësore të shkëmbinjve a formacioneve të tjera gjeologjike të tokës, me porozitet dhe përshkueshmëri të mjaftueshme, që mundësojnë rrjedhje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose nxjerrjen e sasive të konsiderueshme të ujërave nëntokësore.

Disa rregulla për mbrojtjen sanitare paraqiten edhe në Rregulloren “Cilësia e ujit të pijshëm” e cila detyrimin për sistemin e mbrojtjes të burimeve ujore individuale i’a ngarkon subjekteve kërkues, të cilët duhet ti drejtohen Shërbimit Gjeologjik Shqiptar apo një subjekti të licencuar në fushën e hidro-gjeologjisë për përcaktimin e tyre. Në rast kërkese për pajisje me leje për përdorim të ujit të burimit ujqor në AMBU, me qëllim ambalazhimi me kapacitete të ulëta prodhimi, ky studim teknik nuk kërkohet në formularët përkatës të aplikimit. Në mungesë të këtyre akteve përcaktuese, rrezikohet mbrojtja e përshtatshme burimit dhe cilësia e ujit.

**3. Gjetje nga auditimi:** Aktet rregullatore për miratimin e lejeve dhe tarifave për përdorimin e burimit ujqor dhe ato për përmbushjen e cilësisë së tij, krijojnë kontradiktë dhe paqartësi në zbatimin e tyre. Kështu, Rregullorja “Cilësia e ujit të pijshëm”<sup>30</sup> në nenin 8 të saj përcakton se, ndalohet ambalazhimi i ujërave me origjinë sipërfaqësore, qofshin edhe të trajtuara. Ndërkohë vendimi<sup>31</sup> i cili përcakton formularët dhe kriteret për dhënien e burimit ujqor mundëson aplikimin për leje nga një burim ujqor sipërfaqësor. Në të njëjtën mënyrë edhe vendimi i cili përcakton tarifën<sup>32</sup> për përdorimin e ujit të burimit ka parashikuar tarifë për ujin sipërfaqësor që përdoret për ambalazhim. Në një rast është evidentuar se, në Basenin Ujqor Mat leja e miratuar për ambalazhim nga një sipërfaqësor rezultoi e gabuar, pasi sipas dokumentacionit të paraqitur i referohet një burimi nëntokësor.

**4. Gjetje nga auditimi:** Mekanizmi i ngritur për pajisjen me leje/autorizim për përdorim të burimit ujqor, për vitet 2020-2024 nuk ka mundësuar konkurrencë mes projekteve mbi shfrytëzimin e burimit ujqor. Ai mbështetet mbi bazë kërkese individuale të operatorit ekonomik dhe nuk mundëson hapjen e garës për përzgjedhje mes alternativave të tjera të mundshme. Procedura aktuale nuk parashikon kërkesa të detyrueshme lidhur me performancën financiare, detyrimet financiare ndaj institucioneve, deklarimin e pastërtisë së figurës së kompanisë, përfaqësuesve/ ortakëve etj, ndryshe nga kriteret e përdorura në dhënien me koncesion për të njëjtën tipologji apo kriteret e përdorura në një procedurë të zakonshme prokurimi publik. Ndërkohë, filtri i kontrollit është thujse formal. Procedurat e ri-aplikimit pas një afati pesë vjeçar, kanë kërkesat kërkesa edhe më të thjeshtuara dhe nuk kryhet asnjë vlerësim për subjektin kërkues mbi përmbushjen e angazhimeve të marra në planin fillestar. AMBU e cila kryen edhe rolin e sekretariatit teknik për Këshillat e Baseneve, sipas profileve të punës të miratuar për Sektorin e Lejeve dhe Autorizimeve, e cila e përmbush këtë rol, nuk disponon kapacitetet e mjaftueshme për vlerësimin e plotë të planit të biznesit dhe teknologjisë që do të përdoret përpara përcjelljes për vendimmarrje. Nga të dhënat e faturimeve të AMBU rezultoi se rreth 1/5 e subjekteve me leje nuk deklarojnë konsum uji, ndërkohë 2 kontrata janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme prej saj.

Mungesa e kriterëve dhe ekspertizës së nevojshme për procedura vlerësuese përpara miratimit, krijojnë risk për mos përmbushjen e investimeve nga ana e operatorëve të licencuar, përdorimin e pa përshtatshëm të burimit ujqor, dhe mos plotësimin e kriterëve të përpunimit, ruajtjes dhe tregtimit të produktit konform standardeve.

**5. Gjetje nga auditimi:** Për licencimin e stabilimenteve për prodhimin e ujit të pijshëm të ambalazhuar, AKU nuk ka të parashikuar si pjesë procedurale verifikimin nëse operatori i biznesit e disponon paraprakisht lejen e përdorimit të burimit ujqor, pavarësisht se pajisja me leje është një kërkesë e ligjit për burimet ujore dhe Rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”. Lejet e stabilimentit të cilat miratohen prej saj janë pa afat të përcaktuar dhe bëhen objekt ri-vlerësimi

<sup>30</sup> VKM nr. 379 datë 25.05.2016 Rregullorja “Cilësia e ujit të pijshëm”;

<sup>31</sup> VKM nr. 550 datë 15.07.2020 Formulari nr.3;

<sup>32</sup> VKM nr. 993 datë 09.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkuftare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre”;

pjesor, kur ndryshon drejtuesi teknik, vendndodhja etj. Në rast të përfundimit apo pezullimit/revokimit të lejes së përdorimit të burimit, stabilimenti nuk mund të funksionojë për përpunim dhe ambalazhim, pasi uji është lënda e parë e tij. Nuk evidentohet asnjë lloj bashkëpunimi mes AKU dhe AMBU lidhur me stabilimentet apo lejet e burimit në drejtim të shkëmbimit të informacionit apo tjetër. Mos përfshirja e lejes së burimit ujqor në dokumentacionin e detyrueshëm përpara licencimit të stabilimentit nga ana e AKU dhe mungesa e bashkëpunimit me AMBU, nuk garanton një procedurë të përshtatshme të kontrollit ushqimor për këtë produkt.

**6. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore disponon procedura të miratuara që ndiqen nga strukturat që garantojnë monitorim-kontrollin e tyre, lidhur me përmbushjen e kushteve të lejeve. Në to përcaktohet, bashkëpunimi me ente publike, për të harmonizuar dhe bashkërenduar procesin e monitorim/kontrollit të burimeve ujqore. Bashkëveprimet e institucionit me ente të tjera shtetërore për kryqëzimin e informacionit lidhur me të dhënat sasiore dhe cilësore mbi burimet ujqore mungojnë. AMBU nuk ka kërkuar informacione nga palë të tjera si, të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shitjet e produktit brenda vend si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për eksportet e kryera nga ana e prodhuesve të ujqit të ambalazhuar megjithëse në disa ZABU evidentohen luhajtje të konsiderueshme midis faturimeve vjetore sa i përket sasive të ujqit të shitur nga ana e prodhuesve të ujqit të ambalazhuar. Ndërkohë, faturimet e ujqit nga ana e strukturave të AMBU kryhen mbi baza tre mujore. Institucioni ka përcaktuar në aktet e brendshme rregullatorë dy lloj faturimesh, faturimin tre mujor dhe atë mujor. Duke qenë se treguesit buxhetorë janë vjetorë dhe deklarimet e shoqëritë apo subjektet tregtare duhet të bëhen rregullisht në baza mujore bazuar në legjislacionin fiskal dhe raportohen sipas vitit kur konsumi kryhet, kjo mënyrë veprimi nuk mundëson raportim të rregullt sipas vitit ushtrimor për secilën nga palët.

**7. Gjetje nga auditimi:** Kuadri rregullator dhënien e lejeve për ambalazhim bazohet në kriterin sasi shishesh të përpunuara në orë, nuk përfshin përdorimin e autoboteve/boteve apo enë të tjera të cilat nuk konsiderohen ambalazh standard. Në basenet ujqore Shkumbin dhe Seman evidentohen katër raste të lejeve të miratuar për ujqin nëntokësor për ambalazhim (me bot). Për aplikimet në këto raste janë përdorur formularë për ujqin nëntokësor të pijshëm për ambalazhim. Tregtimi i ujqit të pijshëm me autobot/bot nuk parashikohet në rregulloren për cilësinë e ujqit, e cila përcakton qartë përdorimin tij vetëm në raste emergjencash, ose në disa situata kur kjo mënyrë furnizimi është e vetmja mundësi e vlefshme. Procesi i tregtimit por edhe transportimit me autobot/bot zhvillohet jashtë mbikëqyrjes së organeve që garantojnë sigurinë shëndetësore dhe atë ushqimore. Kjo pasi, Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NjVKSH) nuk kryejnë kontrole/monitorime në terren për ujqin e pijshëm të ambalazhuar nga ana tjetër edhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) i kryen inspektimet nëpërmjet një procesi të parapërcaktuar në ambientet e subjekteve tregtarë. Në këto kushte, vazhdimësia e këtij lloj aktiviteti paraqet risk për cilësinë e produktit dhe sigurinë e konsumatorit.

**1. Konkluzioni:** Procedurat për prodhimin dhe certifikimin e ujqit të ambalazhuar paraqesin mangësi, lidhur me proceset dhe procedurat e ndjekura lidhur me miratimin e lejeve për përdorim të burimeve ujqore, licencave të stabilimenteve të prodhimit si edhe monitorimin e përmbushjes së kushteve të tyre. Modeli aktual për dhënien në shfrytëzim të burimit ujqor nuk garanton konkurrueshmëri dhe kriteret e cilat të garantojnë ecurinë e investimeve. Nga ana tjetër, mos përfshirja e lejes së burimit ujqor si kusht për licencimin e stabilimenteve dhe mungesa e monitorimit në vijimësi mbi disponimin e tyre krijon risk në garantimin e sigurisë për këtë produkt. Problematikë mbetet gjithashtu mungesa e bashkëveprimit me institucione të tjera për kryqëzimin e informacioneve të ndërsjellta.

**1.1 Rekomandimi:** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të ndërmarrë hapat e nevojshëm për hartimin e planeve të menaxhimit për Basenet Shkumbin dhe Vjosë, për ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe shfrytëzimin me kriter të tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.1 Rekomandimi:** Ministra e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse, për zonat e mbrojtura, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime dhe autoritetin përgjegjës për hidro-gjeologjinë, të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm administrativë, për përcaktimin dhe miratimin e kufijve të zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare për burimet ujore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.1 Rekomandimi:** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të ndërmarrë iniciativën dhe të bëjë propozimet e nevojshme në Këshillin e Ministrave, për eliminimin e mbivendosjeve të Rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm” me aktet rregullatorë që trajtojnë procedurat dhe tarifatat për ujërat sipërfaqësorë për ambalazhim.

**Brenda datës 31.03.2026**

**4.1 Rekomandimi:** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore nëpërmjet një grupi pune, të analizojë, kriteret për dhënien e lejeve për burimet ujore, transferimin dhe ri-konfirmimin e tyre dhe të bëjë propozimet e nevojshme në Këshillin e Ministrave, me qëllim rishikimin dhe forcimin e tyre.

**Brenda datës 31.07.2026**

**4.2 Rekomandimi:** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të rishikojë profilet e punës për Sektorin e Lejeve dhe Autorizimeve në funksion të mirë analizimit të veprave të marrjes së ujit, linjës industriale, kapaciteteve financiare dhe jo vetëm.

**Brenda datës 31.03.2026**

**5.1 Rekomandimi:** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të miratojë një listë specifike kriteresh për licencimin e stabilimenteve të ujit të pijshëm të ambalazhuar ku veç të tjerash të përfshihet edhe disponimi i detyrueshëm i lejes së vlefshme për përdorimin të burimit ujor për fillimin dhe ushtrimin e aktivitetit.

**Brenda datës 31.03.2026**

**5.2 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të udhëzojë Drejtoritë Rajonale në varësi, që në çdo inspektim për stabilimentet e ujit të përfshihet edhe kontrolli mbi disponimin e lejes së vlefshme për përdorimin e burimit ujor.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.3 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimi të kërkojë periodikisht nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të dhënat zyrtare për lejet e miratuara për përdorim të burimit ujor për ambalazhim dhe ti vendosi në dispozicion të drejtorive rajonale, me qëllim verifikimin e kushteve ligjore për prodhimin e ujit të pijshëm të ambalazhuar në stabilimentet nën juridiksionin e tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.1 Rekomandimi:** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të dhëna mbi shitjet vjetore të kryera nga subjektet tregtare të pajisura me leje për përdorimin e burimit ujor për vitet

ushtrimore 2020-2024, si dhe për çdo vit në vazhdim, për përdorimin e tyre në funksion të procesit të monitorim-kontrollit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.2 Rekomandimi:** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të marrë masa për të kryer faturime mujore për konsumin e ujit të burimit me qëllim raportimin në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

### **Në vijimësi**

**7.1 Rekomandimi:** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore nëpërmjet strukturave të saj të analizojë dhe vlerësojë situatën dhe kushtet në të cilën operojnë operatorët e pajisur me leje përdorimi të burimit ujqor me autobot/bot dhe të ndërmarrë veprimet administrative përkatëse lidhur me këtë aktivitet referuar legjislacionit në fuqi.

### **Menjëherë**

**5.2 Pyetje e auditimit: A kryhet monitorimi dhe survejanca e nevojshme në zinxhirin e proceseve deri në daljen në treg të ujit të ambalazhuar ?**

**5.2.1 A realizohen analizat e nevojshme laboratorike ?**

Uji i ambalazhuar ndahet në dy kategori sipas origjinës, në ujëra burimi dhe ujëra mineral. Analizimi i ujit të ambalazhuar nga burimi, përjashtuar uji mineral, është i rregulluar me VKM nr. 379 “Cilësia e ujit të pijshëm”, e harmonizuar kryesisht me Direktivën evropiane 98/83/EC. Në të përcaktohet se uji i pijshëm, përfshirë dhe atë të ambalazhuar, që të konsiderohet i përshtatshëm për konsum, duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara për praninë e mikroorganizmave, parazitëve dhe substancave të tjera të rrezikshme, në përputhje me vlerat parametrike të specifikuara në këtë rregullore. Gjatë këtij procesi, duhet të merren kampione të ujit për të verifikuar se ai është i sigurt për konsum dhe i përmbahet vlerave të përcaktuara nga AKU dhe NJVKSH-të. Uji sipas kësaj rregulloreje klasifikohet si “i përshtatshëm për përdorim” nëse analizat tregojnë mungesë mikroorganizmash, parazitësh ose substancash që mund të përbëjnë rrezik për shëndetin publik. Në të kundërt, nëse rezultatet e analizave tregojnë shkelje të këtyre kërkesave, uji konsiderohet “i papërshtatshëm për përdorim”.<sup>33</sup>

Nga ana tjetër, uji mineral natyral është një nëntip shumë i veçantë i ujit nëntokësor që vjen nga burime të mbrojtura natyrore. Uji mineral duhet të ketë pastërti të lartë mikrobiologjike dhe një përbërje minerale të qëndrueshme. Kriteret dhe kërkesat e këtij nëntipi uji janë të rregulluara me urdhrin e ministrit të MZHBR-së nr. 266, datë 29.08.2011 për miratimin e rregullores “Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale”, transpozuar sipas Direktivës 2009/54/EC dhe urdhrin nr. 314, datë 27.10.2010 për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e listës, kufijve të përqendrimit dhe kërkesat për etiketimin, për përbërësit natyralë të ujërave minerale dhe kushtet për përdorimin e ajrit të pasuruar me ozon për trajtimin e ujërave minerale natyrale dhe ujërave të burimit”. Institucioni përgjegjës për zbatimin e këtyre urdhrave është AKU, i cili kryerjen e kontroleve për të vlerësuar nëse ky uji mineral plotëson kërkesat e përcaktuara me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

***Laboratorët AKU, NJVKSH dhe ISHP nuk janë të certifikuar/akredituar.***

Sipas rregullores për ujin e pijshëm, laboratorët që kryejnë analizat duhet të përdorin metoda sipas standardit ndërkombëtar ISO, dhe rrjedhimisht duhet të zotërojnë laboratorë të akredituar.

<sup>33</sup> Neni 19, pika 6, shkronja “a” dhe “b” e VKM-së 379 “Cilësia e ujit të pijshëm”.

Nga pyetësorët/intervistat e kryera gjatë auditimit, rezulton se asnjë nga institucionet publike përkatëse që kryejnë analizimin e cilësisë së ujit të pijshëm përfshirë AKU, institucion nën varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, NJVKSH dhe ISHP, nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk zotërojnë aktualisht laboratorë të akredituar për të gjithë parametrat e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.


Gjatë një takimi të zhvilluar me përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik, grupit të auditimit i është bërë e ditur se ISHP nuk është i akredituar, megjithëse përdor metoda analitike të bazuara në standardet ISO dhe ka kryer validimin e metodave që përdor. Pavarësisht këtij validimi, mungesa e akreditimit zyrtar e bën procesin e analizës të papërpunueshëm me kërkesat e VKM-së dhe cenon vlefshmërinë ligjore të rezultateve analitike për qëllime monitorimi.

***AKU nuk ka përmbushur planin vjetor të analizave për ujin e pijshëm të ambalazhuar.***

AKU si institucioni përgjegjës për sigurinë ushqimore në zbatim të ligjit për ushqimin<sup>34</sup>, analizon mostra sipas planit vjetor me bazë risku. Mostrat e ujit të pijshëm të ambalazhuar analizohen për verifikuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe nënligjore për ushqimin dhe urdhrat për ujin mineral. Marrja e mostrave nga AKU ka për qëllim të garantojë që, uji i ambalazhuar që del në treg, të plotësoj kërkesat për sigurinë dhe cilësinë ushqimore, duke përfshirë analizat mikrobiologjike dhe kimike që përcaktohen në rregulloret përkatëse. Në këto plane janë përcaktuar llojet e analizave që do të kryhen dhe laboratorët. Grupi i auditimit ka konstatuar se realizimi i analizave vjetore për ujin e pijshëm të ambalazhuar ka qenë me i ulët se ai i planifikuari. Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së realizimi i analizave nga AKU në Pikën e Inspektimit Kufitar (PIK) dhe në Terren në rang vendi, përgjatë viteve 2020 – 2024, konkretisht paraqitet si më poshtë:

- ✓ Në vitin 2020, janë realizuar 205 analiza nga 244 të planifikuara (84 %).
- ✓ Në vitin 2021, janë realizuar 213 analiza nga 382 të planifikuara (56 %).
- ✓ Në vitin 2022, janë realizuar 217 analiza nga 264 të planifikuara (82 %).
- ✓ Në vitin 2023, janë realizuar 128 analiza nga 206 të planifikuara (62 %).
- ✓ Në vitin 2024, janë realizuar 131 analiza nga 172 të planifikuara (76 %).<sup>35</sup>

Grafiku nr. 6 Realizimi i analizave të planifikuara nga AKU, për vitet 2020-2024 (në %).



*Burimi: AKU*

*Përpunoi: Grupi i auditimit*

Sipas të dhënave më sipër, gjatë periudhës 2020–2024, laboratorët rajonal të AKU-së kanë planifikuar në total 1268 analiza për ujin e pijshëm të ambalazhuar. Nga këto, janë realizuar 894 analiza, që përfaqëson një shkallë realizimi prej 71 % në rang vendi. Megjithatë, ka disa dallime të theksuara ndërmjet qarqeve. Mostrat dhe analizat e realizuara sipas qarqeve si më poshtë:

<sup>34</sup> Ligji Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, neni 38.


<sup>35</sup> Informacion i marr nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së, me e-mail datë 02.06.2025

### **Mbi analizimin e mostrave sipas qarqeve/DRAKU.**

Nga të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së<sup>36</sup>, në qarkun e Tiranës, janë realizuar 31 mostra, të gjitha të marra në terren, për të cilat janë kryer gjithsej 125 analiza. Treguesit e analizuar përfshijnë fortësinë, magnezin, kalciumin dhe bikarbonatet, dhe produkti i testuar ka qenë ujë natyral i ambalazhuar. Theksojmë se Qarku Tiranë është qarku më i madh për popullsinë që ka e rrjedhimisht treguesit janë të ulët.

Në Durrës është vërejtur aktivitetet më i gjerë, me 108 mostra të realizuara, nga të cilat vetëm 20 janë marrë në pika kontrolli dhe 88 në terren. Për këto mostra janë realizuar 240 analiza të ndryshme, që kanë përfshirë tregues të tillë si bikarbonatet, lënda e thatë, parametrat organoleptikë, kloruret, kalciumi dhe fortësia e përgjithshme. Produktet e kontrolluara kanë qenë ujëra natyral mineralë, oligomineralë dhe ujë i gazuar.

Grafiku nr. 7



Burimi: AKU

Përpunoi: Grupi i auditimit

Ndryshe nga qarqet e tjera, në Fier nuk është kryer asnjë mostër gjatë gjithë periudhës objekt auditimi, çka përbën një boshllëk të dukshëm në mbikëqyrjen laboratorike në këtë zonë.

Gjithashtu, në Vlorë realizimi ka qenë i ulët. Nga 17 mostra të planifikuara janë kryer vetëm 7, të gjitha në terren. Janë analizuar parametra si lënda e thatë në 105°C, fortësia, kalciumi, magnezi dhe bikarbonatet, për ujë mineral natyral.

Në Gjirokastër janë realizuar 98 mostra nga 142 të planifikuara. Nga to, 67 janë marrë në terren dhe pjesa tjetër në PIK. Megjithëse numri i mostrave është i lartë, për to është raportuar vetëm një analizë për mostër (lëndë e thatë), tregon një përqendrim të kufizuar në treguesin bazë për secilin produkt.

Ndërkaq, në Korçë, është vërejtur një tejkalim i ndjeshëm i planit të fillestar, pasi janë kryer 94 mostra edhe pse ishin parashikuar vetëm 11. Janë realizuar 256 analiza që përfshijnë tregues si lënda e thatë, aciditeti dhe përmbajtja e gazit karbonik, për produkte si ujë i gazuar dhe ujë

<sup>36</sup> Përgjigje pyetësores me e-mail datë 03.03.2025.


me vitamina. Edhe Shkodra ka shfaqur një përputhje të mirë me planin, me 49 mostra të realizuara, pjesa më e madhe në pika kontrolli, dhe 144 tregues të analizuar. Produkti kryesor ka qenë ujë mineral natyral dhe treguesit përfshijnë mbetjen e thatë, pH dhe përmbajtjen e bikarbonateve.

Në përmbledhje, ndonëse ka një nivel 71 % të realizimit të përgjithshëm të planit në rang kombëtar, dallimet ndërmjet qarqeve janë të theksuara. Në disa rajone ka mungesë të plotë aktiviteti ose përqendrim vetëm në disa parametra bazë, ndërsa në të tjera është vërejtur angazhim më i gjerë dhe analizë më e detajuar, që reflekton qasje të ndryshme të laboratorëve rajonalë në zbatimin e kontrollit të cilësisë së ujit të ambalazhuar.

### ***Mbi realizimin e analizave të adresuara nga AKU në NjVKSH.***

Sipas të dhënave dhe intervistave të zhvilluara në Drejtorinë e përgjithshme të AKU-së, rezulton se AKU gjatë periudhës 2020-2024 nuk ka realizuar analiza mikrobiologjike të ujit të pijshëm të ambalazhuar në laboratorë e saj rajonalë. Kjo pasi laboratorët e AKU-së nuk kanë kapacitete laboratorike për të kryer analiza mikrobiologjike të ujit të pijshëm të ambalazhuar. Për analizimin mikrobiologjik AKU harton një plan reciprok bashkëpunimi me OSHKSH për adresimin e mostrave për analizë në NjVKSH-të rajonale. Konstatohet se, realizimi i mostrave dhe analizave në NjVKSH ka qenë me i ulët se plani. Konstatohet se, në vitet 2022 – 2024 nga ana e NjVKSH-së Tiranë nuk janë pranuar mostrat për analiza mikrobiologjike. Mungesa e bashkëpunimit dhe mosdakordësia midis AKU dhe NjVKSH, për marrëveshjen ndërinstytucionale kanë çuar në mosrealizim të analizave të domosdoshme, duke lënë boshllëqe në mbikëqyrjen dhe analizimin e mostrave. Realizimi i analizave në rang vendi nga NjVKSH-të paraqiten si më poshtë:

Grafiku nr. 8



*Burimi: AKU Përpunoi: Grupi i auditimit*

- ✓ Në vitin 2020, nga 134 analiza të planifikuara u realizuan vetëm 99 (74 %).
- ✓ Në vitin 2021, nga 98 mostra të planifikuara, u morën vetëm 15, dhe nga 567 analiza të planifikuara u realizuan vetëm 95 (16 %).
- ✓ Në vitin 2022, nga 61 mostra të planifikuara u realizuan 35, me 156 analiza të realizuara (41%) nga 385 të planifikuara.
- ✓ Në vitin 2023, u planifikuan 62 mostra dhe u morën 31, duke u realizuar 142 analiza (33 %) nga 433 të planifikuara.
- ✓ Në vitin 2024, u planifikuan 66 mostra dhe u morën 40, me 155 analiza të realizuara (38 %), përfshirë tregues kimiko-fizikë dhe mikrobiologjikë, nga 410 të planifikuara.

Për sa më sipër, mos realizimi i planit të analizave përgjatë viteve 2020 dhe 2024 dhe moskryerja e analizave mikrobiologjike krijon mbikëqyrje jo të plotë për produktin.

***Në planin vjetor me bazë risku të AKU-së, nuk janë përfshirë analiza për disa metale të rënda, mbetje pesticide dhe farmakologjike.***

Në rregulloren e ujit të pijshëm dhe urdhrat për ujin mineral parashikohet analizimi i mbetjeve pesticide, disa metale të rënda dhe farmakologjike. Drejtoria e Vlerësimit të Risku në AKU ka detyrë funksionale organizimin dhe menaxhimin e procesit të vlerësimit të riskut në fushën e sigurisë ushqimore dhe hartimin e planit vjetor kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin<sup>37</sup> në terren, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK. Analiza si Arseniku, Kadmiumi etj., mbetjet pesticide dhe farmakologjike, të përcaktuara në rregullore dhe urdhrat përkatëse, nuk kanë qenë pjesë e planit në analizat vjetore përgjatë viteve 2020 - 2024 nga AKU. Gjithashtu, në ligjin për ushqimin përcaktohet se një produkt ushqimor nuk duhet të përmbajë metale të rënda, mbetje pesticide dhe substanca të tjera të dëmshme për shëndetin e konsumatorëve.<sup>38</sup> Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së, rezulton se Laboratorët Rajonalë të AKU-së nuk kanë kapacitete për të kryer një gamë të gjerë analizash, ndaj shumë mostra i adresojnë në laboratorë si ISUV dhe NjVKSH. Llojet e analizave që kryhen nga laboratorët, ne kuadër të planit me bazë risku janë si më poshtë:

Tabela nr. 7:

| Laboratori                     | Llojet e Analizave   |
|--------------------------------|--|
| Laboratorët Rajonalë të AKU-së | Organo shqisore, Mbetja e thatë në 180°C, pH, Fortësia e përgjithshme, Bikarbonatet, Kloruret, Gaz karbonik, Kalciumi, Magnezi   |
| ISUV (Laboratori i Referencës) | Mbetja e thatë, pH, Fortësia e përgjithshme, Kalciumi, Magnezi, Bikarbonatet, Kloruret   |
| Laboratorët NjVKSH-ve          | Coliform total, Streptokoke fekale, E. coli, Mbetja e thatë në 180°C, pH, Fortësia e përgjithshme, Kalciumi, Magnezi, Sulfatet, Bikarbonatet, Nitrite, Nitrate, Amoniak, Kloruret, Lënda organike, Gazi karbonik |

Burimi: AKU

Përpunoi: Grupi i auditimit

Për sa më sipër, gama e analizave që adresohen në këta laboratorë nuk është e plotë sipas llojit dhe analitëve të përcaktuara në urdhrat për ujin mineral, si dhe rregulloren për cilësinë e ujit të pijshëm për ujërat të cilët nuk janë mineral. Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) mbi realizimin e analizave laboratorike për ujin e pijshëm të ambalazhuar për periudhën 2020–2024, rezulton se përmbajtja e analizave të kryera është e kufizuar kryesisht në disa tregues kimiko-fizikë bazikë, si fortësia, bikarbonatet, kalciumi, magnezi dhe lënda e thatë, ndërkohë që ligji për ushqimin, VKM-ja në fuqi për ujin e pijshëm dhe urdhrat e posaçëm për ujin mineral përcaktojnë detyrimin për të analizuar tregues si metale të rënda, pesticide, arsenik, fluor, mangan, dhe të tjera. Kjo tregon se analizat aktuale nuk përmbushin standardin e plotë ligjor.

<sup>37</sup> Uji i pijshëm i ambalazhuar konsiderohet ushqim sipas ligjit Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, neni 3, pika 1.

<sup>38</sup> Ligji Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, neni 12, pika 1, shkronja “c”.


***Laboratorët nuk kanë kapacitete mjaftueshëm për të kryer gamë të plotë të analizave të ujit të pijshëm të ambalazhuar.***

Në rregulloren për cilësinë e ujit të pijshëm janë përcaktuar përafërsisht rreth 48 parametra analitik të llojit mikrobiologjik, kimiko-fizik, metale të rënda dhe pesticide. Nga ana tjetër, Direktiva evropiane 2020/2184 për ujin e pijshëm parashikon rreth 51 analiza. Nga të dhënat e marra deri tani gjatë auditimit ka rezultuar se aktualisht institucionet të cilat kryejnë analizat e ujit të pijshëm të ambalazhuar nuk kanë kapacitet të mjaftueshme për të kryer llojet e analizave të përcaktuara në rregullore. Gjithashtu, në urdhrat përkatës për ujin mineral parashikohen rreth 23 analiza të llojit mikrobiologjik, kimik dhe metale të rënda.<sup>39, 40</sup>

Më poshtë ilustron krahasimin ndërmjet kapacitetit aktual të laboratorëve në vend për të kryer analiza të ujit të pijshëm të ambalazhuar dhe kërkesave të përcaktuara në kuadrin ligjor kombëtar dhe atë evropian, konkretisht në VKM-në nr. 379, datë 25.05.2016 dhe Direktivën (BE) 2020/2184.

Grafiku nr.9

**Kapaciteti i laboratorëve për të kryer analizat e ujit të pijshëm të ambalazhuar krahasuar me kërkesat e VKM-së 379 dhe Direktivës (BE) 2020/2184 dhe urdhrin për ujin mineral**



***Përpunoi: Grupi i auditimit***

Sipas të dhënave të pasqyruara në grafik, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) rezulton institucioni me kapacitetin më të lartë analizues, duke kryer 43 analiza, çka përbën një përputhje të konsiderueshme me kërkesat e Direktivës së BE-së, VKM-së 379 për ujin e pijshëm dhe urdhrave për ujin mineral. Megjithatë, gjatë auditimit ka rezultuar se ISHP nuk është e përfshirë në proceset e analizimit të ujit të pijshëm të ambalazhuar, por kryen analiza vetëm me kërkesë të subjekte private dhe publike që adresohen.

<sup>39</sup> Urdhri nr. 314, datë 27.10.2010 për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e listës, kufijve të përqendrimit dhe kërkesat për etiketimin, për përbërësit natyralë të ujërave minerale dhe kushtet për përdorimin e ajrit të pasuruar me ozon për trajtimin e ujërave minerale natyrale dhe ujërave të burimit”, Shtojca I.

<sup>40</sup> Urdhri nr. 266, datë 29.08.2011 për miratimin e rregullores “Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale”, Shtojca 1.

Nga ana tjetër, AKU, siç është sqaruar dhe më sipër, pavarësisht se kapaciteti i laboratorëve të AKU-së paraqitet dukshëm i ulët, me vetëm 9 analiza në rang vendi, ka një diferencë midis analizave që kryen ndërmjet qarqeve. Konkretisht, nga pyetësorët dhe intervistat e kryera në DRAKU Fier, grupi i auditimit ka konstatuar se në laboratorin rajonal Fier nuk kryhet aktualisht asnjë analizë për ujin e pijshëm të ambalazhuar, pasi nuk ka kapacitetet e duhura për të kryer analizat e kërkuara. Gjithashtu, nga të dhënat e marra nga DRAKU Gjirokastrë, në laboratorin rajonal kryhet vetëm një tregues analitik (lëndë e thatë).

Ndërsa, NjVKSH-të nuk janë aktualisht në gjendje të përmbushin kërkesat e analizave, të përcaktuar në rregulloret për ujin e pijshëm dhe urdhrat për ujin mineral ku kapaciteti i laboratorëve dhe adresimi i analizave nga AKU është për 13 tregues. Në vetvete, grafiku si më sipër vë në dukje mospërputhjen ndërmjet kërkesave ligjore dhe kapaciteteve reale teknike dhe analitike të institucioneve që kryejnë analizat e ujit e pijshëm.

***Në rregulloren për cilësinë e ujit të pijshëm nuk përfshihen disa ndotës të rinj të njohur si rrezik potencial.***

Bazuar në shqyrtimin e Direktivës (BE) 2020/2184 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian “për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor” dhe Rregullores shqiptare të miratuar me VKM nr. 379, datë 25.05.2016, e përditësuar, konstatohet se legjislacioni kombëtar është kryesisht i harmonizuar me kërkesat e mëparshme evropiane (Direktiva 98/83/EC), por nuk pasqyron ende risitë e plota të direktivës së re të vitit 2020.

Në lidhje me ujin e pijshëm të ambalazhuar:

- Të dy aktet përfshijnë në fushën e tyre të zbatimit ujin e ambalazhuar dhe vendosin standarde të detyrueshme për parametra mikrobiologjikë dhe kimikë, por nuk përfshin disa ndotës të rinj të njohur si rrezik potencial, si Bisphenol A, mikroplastika dhe PFAS, të cilat janë tashmë pjesë e listës së vëzhgimit në nivel BE-së.

Tabela më poshtë përmbledh disa nga kërkesat për analizat e ujit të pijshëm të ambalazhuar sipas Direktivës (BE) 2020/2184 dhe Rregullores shqiptare (VKM nr. 379, datë 25.05.2016, e ndryshuar).

Simbole: ✓ - e kërkuar; ✗ - mungon.

Tabela nr. 8 Të dhëna krahasimore mbi analizat e ujit të pijshëm të ambalazhuar

| Kategoria                    | Direktiva BE 2020/2184 | Rregullorja Shqiptare VKM 379 |
|------------------------------|------------------------|-------------------------------|
| E. coli                      | ✓                      | ✓                             |
| Enterokokët                  | ✓                      | ✓                             |
| Pseudomonas aeruginosa       | ✓                      | ✓                             |
| Numërim kolonish (22°C/37°C) | ✓                      | ✓                             |
| Nitrate                      | ✓                      | ✓                             |
| Nitrite                      | ✓                      | ✓                             |
| Plumb (Pb)                   | ✓ 5 µg/l               | ✓ 10 µg/l                     |
| Arsenik                      | ✓                      | ✓                             |
| Kadmium                      | ✓                      | ✓                             |
| Merkur                       | ✓                      | ✓                             |
| Bisfenol A                   | ✓                      | ✗                             |
| PFAS                         | ✓                      | ✗                             |
| Mikroplastika                | ✓                      | ✗                             |
| Pesticide individuale        | ✓                      | ✓                             |
| Total pesticide              | ✓                      | ✓                             |
| Trihalometanet               | 100 µg/l               | 150 µg/l (deri më 31.12.2024) |

Burimi: Direktiva BE 2020/2184, VKM nr. 379

Përpunoi: Grupi i auditimit

Analizimi i substancave të reja në ujin e pijshëm të ambalazhuar, si mikroplastika dhe Bisphenol A (BPA) dhe PFAS është i rëndësishëm për të garantuar sigurinë afatgjatë të konsumatorit dhe për të identifikuar rreziqe potenciale që nuk adresohen në analizat tradicionale mikrobiologjike dhe kimike.



**Mikroplastika** - është identifikuar nga OBSH si e pranishme në ujërat e ambalazuara dhe mund të veprojë si bartëse e ndotësve kimikë apo mikroorganizmave. Edhe pse aktualisht nuk ka prova të mjaftueshme për rreziqe të drejtpërdrejta, monitorimi i saj është i domosdoshëm për të parandaluar ekspozimin afatgjatë ndaj grimcave plastike që mund të ndikojnë në shëndetin publik.<sup>41</sup>

**Bisphenol A (BPA)** - është një përbërës që mund të migrojë nga plastika e shisheve në ujin e ambalazhuar.<sup>42</sup> Në raportin e OBSH/FAO theksohet se uji i ambalazhuar në shishe plastike mund të përmbajë sasi të vogla të Bisfenol A për shkak të migrimit nga materiali polikarbonat i përdorur në prodhimin e këtyre enëve. Migrimi ndikohet nga faktorë si temperatura, koha e ruajtjes dhe lloji i plastikës së përdorur.<sup>43</sup> BPA është identifikuar si një çrregullues endokrin, me ndikim të mundshëm në sistemin hormonal, zhvillimin neurologjik dhe riprodhues.<sup>44</sup> Për këtë arsye, OBSH rekomandon monitorimin e migrimit të BPA-së në ujin e pijshëm të ambalazhuar. Matja dhe kontrolli i niveleve të BPA-së janë thelbësore, veçanërisht për produktet që ruhen gjatë në kushte jo optimale.

**PFAS** - përbëjnë një grup shumë të madh përbërjesh sintetike fluoruese, të përdorura në një gamë të gjerë aplikimesh industriale dhe konsumatori: nga tekstilet dhe enët e gatimit, deri te paketimet ushqimore dhe shishet plastike. Sipas **OBSH-së**, uji i pijshëm është një nga burimet kryesore të ekspozimit të popullatës ndaj PFAS<sup>45</sup>, ndaj analizimi i tij është i rëndësishëm.

Përfshirja e këtyre substancave në programet e monitorimit të cilësisë së ujit është në përputhje me praktikat bashkëkohore të sigurisë ushqimore dhe ndihmon në përmirësimin e transparencës, mbrojtjes së konsumatorit dhe përafrimit me standardet e BE-së.

Nga të dhënat e marra nga MSHMS dhe ISHP, rezulton se për ujin e pijshëm të ambalazhuar nuk është kryer asnjë studim mbi risqet që mund të paraqesin në shëndetin publik. Studimi i fundit nga ISHP-së për ujin e pijshëm të ambalazhuar ka qenë në vitin 2004 – 2005, periudhë kohore në të cilën filloi prodhimi i ujit të ambalazhuar në vend. Lidhur me përfshirjen e substancave të reja si më sipër, ISHP nga përgjigjet e pyetësorëve<sup>46</sup>, vlerëson përfshirjen e ndotësve të rinj, por nuk disponon aktualisht kapacitetet laboratorike për kryerjen e tyre.

**8. Gjetje nga auditimi:** Laboratorët që kryejnë analizat e ujit të pijshëm duhet të përdorin metodat e analizave sipas standardit ndërkombëtar ISO/IEC 17025, të përcaktuar në rregulloren e ujit të pijshëm e miratuar me VKM nr. 379 datë 25.05.2016, e ndryshuar. Nga auditimi u

<sup>41</sup> OBSH (2022). *Mikroplastika në ujin e pijshëm*: <https://cdn.who.int/media/docs/default-source/wash-documents/microplastics-in-dw-information-sheet190822.pdf>, fq. 1. Rekomandime.

<sup>42</sup> OBSH/FAO (2011). Aspektet toksikologjike dhe shëndetësore të Bisfenol A. Raport i një Takimi të Përbashkët të ekspertëve FAO/OBSH, Otava, Kanada, 2–5 Nëntor 2010. Gjenevë: OBSH: [https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/44624/97892141564274\\_eng.pdf?sequence=1](https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/44624/97892141564274_eng.pdf?sequence=1) fq. 14 & 15.

<sup>43</sup> [https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/44624/97892141564274\\_eng.pdf?sequence=1](https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/44624/97892141564274_eng.pdf?sequence=1) fq. 18 & 19.

<sup>44</sup> [https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/44624/97892141564274\\_eng.pdf?sequence=1](https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/44624/97892141564274_eng.pdf?sequence=1) fq. 38 – 42.

<sup>45</sup> OBSH–Substancat Per- dhe Polifluoroalkil (PFAS) në ujin e pijshëm: <https://www.who.int/teams/environment-climate-change-and-health/water-sanitation-and-health/chemical-hazards-in-drinking-water/per-and-polyfluoroalkyl-substances>

<sup>46</sup> Përgjigje pyetësori me e-mail, datë 28.05.2025.

konstatua se, asnjë prej laboratorëve shtetërorë të përfshirë në analizimin e ujit të pijshëm të ambalazhuar si AKU, NJVKSH dhe ISHP nuk janë aktualisht të akredituar për parametrat që kërkon rregullorja në fuqi. Mungesa e akreditimit cenon vlefshmërinë ligjore të analizave dhe rrit rrezikun për mospërputhje me standardet, duke ndikuar në sigurinë e konsumatorëve dhe besueshmërinë e kontrolleve zyrtare.

**9. Gjetje nga auditimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si institucioni përgjegjës për sigurinë ushqimore, në zbatim të ligjit për ushqimin, ka detyrimin të kryejë analizën e mostrave të ujit të pijshëm të ambalazhuar sipas një plani vjetor të bazuar në risk. Megjithatë, nga verifikimet e auditimit rezultoi se, AKU nuk kryen analizat mikrobiologjike dhe nuk garanton kryerjen e plotë të analizave fiziko-kimike në nivelin e drejtorive rajonale (DRAKU). Gjithashtu, u evidentuan ndryshime të theksuara ndërmjet qarqeve në zbatimin e planit të kontrollit zyrtar. Në veçanti, në Qarkun Fier nuk është kryer asnjë mostër gjatë gjithë periudhës së audituar, duke krijuar një boshllëk të dukshëm në kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm të ambalazhuar në këtë zonë. Edhe në Qarkun Vlorë, realizimi ka qenë i ulët, ku nga 17 mostra të planifikuara janë analizuar vetëm 7 të tilla. Ndërkohë edhe në Qarkun Tiranë, më i madhi në vend, situata paraqitet gjithashtu me numër të ulët mostrash dhe analizash të kryera. Mostrat për analizat mikrobiologjike dhe për disa tregues fiziko-kimikë janë adresuar kryesisht në laboratorët e Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NjVKSH), të cilat në nivel kombëtar, kanë kryer më pak se 40% të analizave të adresuara. Mosrealizimi i këtyre analizave, veçanërisht i atyre mikrobiologjike, lë pa mbikëqyrje parametra thelbësorë që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar që konsumohet nga qytetarët.

**10. Gjetje nga auditimi:** Rregullorja për ujin e pijshëm dhe urdhrat e ministrit për ujin mineral, përcaktojnë kryerjen e analizave të ujit të pijshëm të ambalazhuar për disa metale të rënda (si Kadmiumi dhe Arseniku), mbetjet e pesticideve dhe farmakologjike. Megjithatë, këta tregues nuk janë përfshirë në planet vjetore të analizave të hartuara nga AKU për periudhën 2020–2024. Kjo mos përfshirje ka sjellë mos përmbushje të kërkesave të legjislacionit dhe ka lënë pa monitorim disa nga ndotësit me rrezik për shëndetin e konsumatorit.

**11. Gjetje nga auditimi:** Direktiva evropiane (BE) 2020/2184 përcakton analizimin e rreth 51 treguesve analitik për cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar, VKM nr.379/2016 parashikon 48 tregues, urdhrat e ujit mineral përcaktojnë rreth 23 tregues analitik e ujit të pijshëm të ambalazhuar. Kapacitet e ISHP mbulojnë me analiza 43 nga 51 tregues të kërkuar nga Direktiva (BE) 2020/2184, NjVKSH-të kryejnë analizimin për rreth 13 tregues, kryesisht mikrobiologjik dhe fiziko-kimik ndërsa AKU kryen analiza për vetëm 9 tregues fiziko-kimikë bazë. Aktualisht, AKU dhe NjVKSH-të nuk disponojnë kapacitetet e nevojshme laboratorike për të kryer analizat për metale të rënda dhe pesticide. Evidentohet se, kapacitetet e ISHP nuk janë shfrytëzuar nga institucionet të cilat kanë pasur mungesë kapacitetesh për mbikëqyrjen e plotë laboratorike të cilësisë së ujit të ambalazhuar. Ky institucion, ka kryer një numër të konsiderueshëm analizash për mostra uji me kërkesë të vetë subjekteve dhe në pak raste të adresuara prej institucioneve shtetërore, AKU apo NJVKSH.

**12. Gjetje nga auditimi:** Rregullorja “Cilësia e ujit të pijshëm” e miratuar me VKM nr. 379/2016 është e përditësuar me Direktivën 98/83/EC, por nuk reflekton ndryshimet e fundit të Direktivës 2020/2184 për ndotësit të rinj si BPA, mikroplastika dhe PFAS. Kjo mospërputhje e vonuar pengon arritjen e standardeve bashkëkohore të BE-së dhe kufizon adresimin e rreziqeve nga ndotësit e rinj për shëndetin publik.

**2. Konkluzioni:** Analizat për ujin e pijshëm të ambalazhuar nuk realizohen plotësisht sipas kërkesave ligjore. Laboratorët nuk janë të akredituar, kapacitetet janë të kufizuara dhe nuk përfshihen të gjithë ndotësit e detyrueshëm. Plani i analizave nuk përmbushet, ndërsa legjislacioni nuk pasqyron standardet më të reja të BE-së. Si rrjedhojë, mbikëqyrja e produktit ujë i ambalazhuar paraqitet e pa mbuluar.

**8.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të marri masa për të akredituar laboratorët e Institutit të Shëndetit Publik dhe Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor, për të përmbushur detyrimet ligjore, plotësimin e standardeve të kërkuara dhe garantimin e besueshmërisë së analizave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.2 Rekomandimi:** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marri masa për të akredituar laboratorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimi, për të përmbushur detyrimet ligjore, plotësimin e standardeve të kërkuara, gamës së nevojshme të analizave për garantimin e besueshmërisë së tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**9.1 Rekomandimi:** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, të marrin masa për përmirësimin e kapaciteteve laboratorike dhe adresimin e analizave në laboratorë të tjerë shtetërorë për analiza të specializuara mikrobiologjike, fiziko-kimike, etj për ujin e pijshëm të ambalazhuar, deri në përmirësimin e kapaciteteve të veta.

**Menjëherë**

**9.2 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të rishikojë dhe forcojë zbatimin e planit të analizave me bazë rrisht, duke garantuar mbulim të rregullt dhe të barabartë në të gjitha qarqet. Në rastet kur plani nuk mund të realizohet për arsye objektive në një qark të caktuar, AKU të parashikojë mekanizma për të ri-alokuar analizat në qarqe të tjera, në mënyrë që të sigurohet realizimi i plotë i planit kombëtar të kontrollit.

**Në vijimësi**

**10-11.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të rishikojë planin vjetor të analizave, për të përfshirë të gjithë treguesit e përcaktuar në legjislacionin përkatës në fuqi që vlerësojnë cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar që hidhet në treg për konsumatorin.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**12.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të nisë procedurat për rishikimin dhe përditësimin e Rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm” miratuar me VKM nr. 379/2016, në përputhje me Direktivën e re të BE-së, duke përfshirë të gjithë ndotësit emergjentë dhe parametrat e rinj si, BPA, mikroplastika e PFAS dhe të tjerë në vijimësi, që ndihmojnë në mbrojtjen e konsumatorit.

**Brenda datës 31.07.2026**

## 5.2.2 A kryhen monitorimet dhe bashkëveprimet e duhura nga institucionet përgjegjëse?

### **Monitorimi i ujit të pijshëm të ambalazhuar në stabilimente nuk përfshin fazën nga burimi në stabiliment.**

Sipas VKM nr. 379, strukturat rajonale të shëndetit publik (NjVKSH-të) kanë detyrimin për të kryer monitorimin e jashtëm të ujit të pijshëm, përfshirë edhe ujin e ambalazhuar. Ky monitorim duhet të kryhet në përputhje me frekuencën e përcaktuar bazuar në vëllimin e prodhimit të ujit.<sup>47</sup>

Bazuar në rregullore shpeshësia e marrjes së mostrave për kontrollin e ujërave të ambalazuara në shishe apo në enë është:

| Vëllim i ujit të prodhuar çdo ditë në shishe apo në enë (1) | Kontrolli rutinë – numri i .kampionëve në vit                  | Kontrolli verifikues – Numri i kampionëve në vit              |
|---|--|---|
| <10 <sub>s</sub>  | 1  | 1   |
| m > 10 ≤ 60   | 12   | 1   |
| > 60  | 12 + 1 për çdo 5 m <sup>3</sup> dhe fraksion të vëllimit total | 1+1 për çdo 100 m <sup>3</sup> dhe fraksion të vëllimit total |

(1) Vëllim i llogaritur si mesatare të marra gjatë një viti kalendarik

Burimi: VKM 379

Nga dokumentacioni i siguruar dhe nga intervistat me përfaqësues të NjVKSH-ve dhe AKU-së, rezulton se pas ndryshimeve në legjislacionin në vitin 2020 për inspektimin sanitar<sup>48</sup>, NjVKSH-të nuk kanë kryer më monitorimin e jashtëm të ujit të ambalazhuar. Institucionet si MSHMS dhe NjVKSH kanë interpretuar se kjo përgjegjësi tashmë i takon vetëm Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU). Megjithatë, rregullorja për cilësinë e ujit të pijshëm nuk është përditësuar për të reflektuar ndryshimet ligjore duke e lënë një pjesë të zinxhirit të monitorimit të ujit të pijshëm të ambalazhuar të pa mbuluar. Nga ana tjetër, në ligjin për ushqimin përcaktohet se termi “ushqim” përfshin edhe ujin të përdorur si ujë të pijshëm për furnizimin publik të popullsisë, të përdorur dhe/ose të bashkuar në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij dhe të paketuar si ujë tryeze, ujë mineral dhe ujë burimi. Aktualisht vetëm uji i ambalazhuar kontrollohet nga AKU. Ndërsa, uji i pijshëm për furnizimin publik të popullsisë monitorohet nga strukturat rajonale të shëndetit publik (NjVKSH-të). AKU kryen marrjen e mostrave vetëm në produktin final të ambalazhuar, ndërsa nuk monitoron fazën e prodhimit të ujit në stabiliment apo në burim. Kjo fazë monitorohet vetëm nga subjekti prodhues. Kjo ka sjellë një boshllëk të qartë monitorimi për këtë kategori të ujit të pijshëm. Ndryshimet ligjore dhe mungesa e një ndarje të qartë të kompetencave ndërmjet AKU-së dhe NjVKSH-ve kanë sjellë konfuzion institucional dhe ndërprerje të funksionit të monitorimit për ujin e pijshëm të ambalazhuar. Si pasojë, cilësia e ujit gjatë fazave të prodhimit dhe para ambalazhimit mbetet e pa monitoruar, duke krijuar rrezik për mungesë gjurmueshmërie dhe sigurie në zinxhirin e furnizimit me ujë të pijshëm.

### **Nuk është hartuar një plan bashkëpunimi i miratuar mes AKU-së dhe NjVKSH-së.**

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), siç është sqaruar dhe me sipër, në kuadër të detyrimeve të tij ligjore për garantimin e sigurisë ushqimore, merr mostra për analiza mikrobiologjike dhe disa tregues fiziko-kimikë dhe i adreson ato në NjVKSH-të. Si pasojë e kapaciteteve të kufizuara laboratorike për kryerjen e analizave mikrobiologjike, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ka ndërmarrë hapa për të përgatitur një akt-marrëveshje me Operatorin

<sup>47</sup> VKM nr. 379, datë 25.05.2016, neni 21 dhe shtojca II – analizat e ujit të pijshëm.

<sup>48</sup> Ligjin 7463, datë 02.12.1992 “Për Inspektimin Sanitar” me Ligjin Nr. 54/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit për Inspektimin Sanitar.”

Shëndetësor (OSHKSH), me qëllim që analizimi i mostrave të realizohet nga strukturat rajonale të shëndetit publik (NjVKSH-të) në varësi të këtij institucioni.

Gjatë viteve 2020 dhe 2021, analiza të tilla janë adresuar dhe realizuar nga NjVKSH-të. Por, në vitin 2022, ky realizim është ndërprerë nga NjVKSH Tiranë, duke refuzuar pranimin e mostrave të dërguara nga AKU. Gjatë vitit 2022, ky institucion nuk ka pranuar mostrat e dërguara nga AKU, çka ka detyruar këtë të fundit t'i drejtohet me një shkresë zyrtare. Në përgjigje të kësaj shkrese, në vitin 2022 NjVKSH Tiranë ka deklaruar se mospranimi i mostrave është bazuar në rregulloren nr. 5, datë 25.06.1993 “Për marrjen e produkteve ushqimore për analizë laboratorike”, e cila vazhdon të jetë në fuqi për strukturat rajonale të shëndetit publik (pra NjVKSH-të). Sipas kësaj përgjigjeje sqaron se, sipas rregullores<sup>49</sup>, NjVKSH mban përgjegjësi për përcaktimin e arsyes së kampionimit, realizimin e ekzaminimit dhe vlerësimin higjieno-sanitar të produktit, duke kërkuar njoftim paraprak 48 orë para ditës së inspektimit. Si pasojë e mospranimit të mostrave për analizat mikrobiologjike, AKU i`u drejtua në vitin 2023 me një shkresë zyrtare OSHKSH-së, institucionit epror të NjVKSH-ve. Në të është ngritur shqetësimi për mospranimin e 37 mostrave të planifikuara për atë vit, si dhe duke theksuar se e njëjta situatë kishte ndodhur edhe në vitin 2022, ndryshe nga vitet e mëparshme kur bashkëpunimi kishte funksionuar pa probleme. Në vijim të kësaj shkrese, OSHKSH i ka kërkuar zyrtarisht NjVKSH Tiranë mendim mbi këtë çështje, duke iu referuar edhe draft-marrëveshjes së përgatitur nga AKU. Në përgjigje kjo e fundit shprehu dakordësinë në parim për bashkëpunimin me AKU, duke vënë në dukje se zotëron kapacitet laboratorik për analizat mikrobiologjike, por theksoi se në marrëveshje duhet të përcaktohet qartë kush do të mbulojë kostot financiare për analizimin e mostrave. Gjithashtu, u specifikuan detyrimet që duhet të marrë secila palë në kuadër të marrëveshjes. Pavarësisht këtij komunikimi, në vitin 2024 u hartua sërish një akt-marrëveshje ndërmjet AKU dhe OSHKSH, por ajo mbeti e pa miratuar. Për sa më sipër, akt marrëveshja mes palëve nuk është miratuar duke e lënë bashkëpunimin në analizimin e produktit vetëm në komunikime shkresore. Nga intervistat dhe dokumentacioni i grumbulluar, grupi i auditimit ka konstatuar gjithashtu se mungon përfshirja dhe ndërhyrja e ministrive përgjegjëse (MSHMS dhe MBZHR) për të zgjidhur ngërçin institucional ose për të nxjerrë një akt të detyrueshëm bashkëpunimi. Për rrjedhojë, deri në momentin e auditimit, nuk ekziston asnjë marrëveshje e firmosur ndërinstitucionale për vijimin e analizave laboratorike të ujit të pijshëm të ambalazhuar, duke e lënë këtë segment të sigurisë ushqimore të pambulluar dhe konsumatorin të pambrojtur.

Megjithatë, grupi i auditimit ka konstatuar se në ndryshim nga qarku i Tiranës dhe Durrësit, qarku i Gjirokastrës ka pasur një bashkëpunim të mirë midis DRAKU dhe NjVKSH Gjirokastrë, duke mos penguar kontrollin zyrtar të këtij produkti. Në përfundim, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet AKU dhe OSHKSH ka krijuar një vakum në sistemin e kontrollit të cilësisë së ujit të ambalazhuar, ka penguar realizimin e analizave të domosdoshme mikrobiologjike në disa qarqe dhe ka cenuar objektivin parësor të legjislacionit ushqimor, për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit.

***Nuk është hartuar një udhëzues teknik për stabilimentet e prodhimit të ujit të pijshëm të ambalazhuar.***

Në VKM-në nr. 379, për cilësinë e ujit të pijshëm përcaktohet se Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë duhet të përshtatin udhëzime teknike për ujin e pijshëm të ambalazhuar në shishe apo enë.<sup>50</sup> Grupi i auditimit ka konstatuar se MSHMS dhe MBZHR nuk ka kanë hartuar një udhëzues teknik për kriteret që duhet të

---

<sup>49</sup> Rregullorja nr. 5, datë 25.06.1993 “Për marrjen e produkteve ushqimore për analizë laboratorike”

<sup>50</sup> VKM nr. 379, datë 25.05.2016, neni neni 4, pika 2.

plotësojnë subjektet që ushtrojnë aktivitetin në prodhimin dhe ambalazhimin e ujerve natyror të pijshëm.

Për më tepër, nga intervistat dhe pyetësorët e zhvilluar me përfaqësues të NjVKSH-Tiranë, rezulton se aktualisht nuk ekziston një procedurë e standardizuar për marrjen e mostrave të ujit të pijshëm nga një burim apo nga shishe. Në mungesë të një udhëzimi specifik, NjVKSH operon në bazë të Rregullores Nr. 5, datë 25.06.1993 “Për marrjen e mostrave të produkteve ushqimore për analizë laboratorike”, e cila nuk është e përshtatur për veçoritë e ujit të pijshëm të ambalazhuar.

***Institucionet shëndetësore që analizojnë ujin e pijshëm të ambalazhuar nuk kanë bashkëveprim me AKU-në për rastet e rezultuara jo konform.***

Në VKM-në 379 për ujin e pijshëm përcaktohet se, në rast të mos respektimit të vlerave parametrike ose specifike të përcaktuara në rregullore, struktura rajonale e shëndetit publik (NjVKSH) klasifikon ujin si “të përshtatshëm apo të papërshtatshëm për përdorim nga njerëzit”. Kjo sipas rrezikut që uji paraqet për shëndetin publik. Ajo rekomandon masat që duhet të marrë administratori për rivendosjen e cilësisë së tij dhe informon disa institucione përkatësisht ISHSH-në, AUB-në dhe ERRU-në. Siç është sqaruar dhe më sipër, pas ndryshimeve ligjore për inspektimin higjieno-sanitar lidhur me produktet ushqimore, përgjegjësia nga ISHSH i ka kaluar AKU-së. Këtu përfshihet edhe produkti “ujë i pijshëm i ambalazhuar”. Nga pyetësorët dhe intervistat e kryera me NjVKSH-Tiranë, grupit të auditimit i është bërë e ditur se gjatë periudhës 2020 – 2024, NjVKSH – Tiranë ka analizuar vetëm mostrat e ujit me kërkesë nga subjektet e interesuara (vetëkontroll) ose të adresuara nga AKU. Në rastet e rezultuar me parregullsi (jo konform), ky institucion i përgjigjet vetëm kërkesave për kontroll të brendshëm të cilësisë së ujit nga vetë subjektet tregtuese. Gjatë viteve 2020-2024 kanë rezultuar jo-konform 26 raste për analiza mikrobiologjike të ujit të ambalazhuar dhe janë ri-analizuar 28 kampione, nga ku kanë rezultuar të përshtatshme për konsum. Konkretisht rastet e mostrave jo- konformë dhe rastet e ri-testuara si më poshtë:

Tabela nr.9 Numri i mostrave jo-konform dhe ri-testimeve sipas viteve në NJVKSH Tiranë.

| Viti | Numri i Mostrave Jo konform | Ri-testuar |
|------|-----------------------------|------------|
| 2021 | 6                           | 5          |
|      | 3                           | 3          |
|      | 1                           | 1          |
| 2022 | 3                           | 6          |
|      | 3                           | 3          |
|      | 2                           | 2          |
|      | 1                           | 1          |
|      | 1                           | 2          |
| 2023 | 2                           | 1          |
|      | 1                           | 1          |
| 2024 | 3                           | 3          |

*Burimi: NjVKSH – Tiranë*

Për sa më sipër, nga të dhënat e marra nga NjVKSH – Tiranë rezulton se, rastet e analizave jo-konform të konstatuara nga NjVKSH Tiranë gjatë viteve 2020 - 2024, nuk janë raportuar në AKU, apo institucioneve të tjera të parashikuara në rregullore. Ato i janë adresuar vetëm subjektit që ka bërë kërkesën. Njoftimi i AKU-së bëhet vetëm në rastet kur kërkesa vjen nga ta. Mos informimi i AKU-së dhe institucioneve të tjera për raste jo konform e bën të pamundur

aktivizimin e mekanizmave institucionale, përfshirë ndërhyrjen për ndalimin e shpërndarjes së produktit, urdhërimin për përmirësimin e procesit të prodhimit apo të ambalazhimit dhe informimin e publikut.

Nga ana tjetër ISHP gjithashtu kryen analiza të ujit të pijshëm të ambalazhuar. Analizat kryhen me kërkesë të subjekteve publike dhe private. Interpretimi i jepet vetëm subjektit apo institucionit që ka kryer kërkesën. Nga pyetësorët drejtuar ISHP-së ka rezultuar se gjatë viteve 2020-2023, janë kryer gjithsej 30 analiza mostrash të ujit të burimeve natyrore dhe ujit të ambalazhuar, nga të cilat 13 analiza kanë rezultuar jo konform. Analizat janë kryer për ujë burimi natyror dhe ujë të filtruar, duke përfshirë burime të ndryshme nga stabilimente prodhimi uji të ambalazhuar. Njëlloj si në rastet e NJVKSH-së rastet e jo- konformitetit nga ISHP nuk janë adresuar në institucione të tjera.

Në këtë mënyrë, mungon një përgjigje e koordinuar ndaj rrezikut, duke i lënë vendin një qasjeje të fragmentuar dhe jo efektive. Për më tepër, një sistem i tillë i shkëputur dhe jo i integruar dëmton besueshmërinë publike në kontrollet zyrtare dhe në cilësinë e produkteve që qarkullojnë në treg. Konsumatori mbetet i pambrojtur ndaj devijimeve që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e tij, ndërsa autoritetet përkatëse humbasin mundësinë për të ndërmarrë veprime korrigjuese dhe për të rritur cilësinë e mbikëqyrjes. Kjo situatë tregon se nuk ka një mekanizëm raportimi, koordinimi dhe ndërhyrjes institucionale në mbrojtje të sigurisë ushqimore dhe shëndetit publik.

#### ***Mbi rastet jo – konformë të ndjekura nga AKU.***

- Në vitin 2021, laboratorit i Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) evidentoi një rast të ujit të pijshëm të ambalazhuar me rezultat jo konform, pas një kërkesë të ardhur nga NjVKSH-ja Elbasan. Nga informacioni i marrë nga ISHP, rezulton se rasti është iniciuar fillimisht nga Drejtoria Rajonale e AKU Elbasan, pas një ankese nga konsumatori. Mostra është adresuar fillimisht pranë NjVKSH Elbasan dhe më pas është dërguar për analizë në ISHP. Analizat treguan prani mbi normën e lejuar për ndotës mikrobiologjikë (*E. Coli 2*), ndotës i cili nuk duhet të jetë i pranishëm në ujin e pijshëm të ambalazhuar.

Në vijim të këtij rasti, grupi i auditimit iu drejtua Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për të verifikuar ndjekjen administrative të çështjes. Bazuar në vendimin përfundimtar të inspektimit të datës 14.12.2021 nga DR AKU Elbasan, subjekti prodhues u urdhërua të kryente një procedurë të plotë pastrimi dhe dezinfektimi të ambienteve të punës, linjës teknologjike, pajisjeve dhe zonës përreth burimit të ujit dhe tubacionit të furnizimit. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, ai duhej të njoftonte NJVKSH dhe ISHP Elbasan për të mundësuar monitorimin, inspektimin dhe analizimin e mostrave të produktit, deri në konfirmimin e përputhshmërisë me vlerat parametrike të lejuara, në përputhje me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për cilësinë e ujit të pijshëm”.

Subjekti u detyrua të përballonte edhe shpenzimet për analizimin laboratorik të produktit “Ujë mineral natyral 1.5 litra me afat përdorimi 28.11.2023”, në vlerën 500 lekë, bazuar në raport-analizën nga ISHP. Për shkeljet e konstatuara, ndaj subjektit u vendos një gjobë administrative prej 300,000 lekësh, ndërkohë që u bllokua një sasi prej 6,800 litrash ujë të ambalazhuar nga produkti i rezultuar mbi normë.

Më 06.06.2022, subjekti paraqiti kërkesë për rinisjen e aktivitetit, duke vetëdeklaruar se kishte zbatuar detyrat e lëna. Megjithatë, nga vendimi përfundimtar i inspektimit i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU, grupi i auditimit konstaton se, në procesverbalin e inspektorëve nuk jepet informacion i plotë mbi zbatimin e detyrave specifike të vendosura më parë. Në dokumentacion thuhet vetëm se subjekti ka instaluar ujë të rrjedhshëm në lavaman dhe se është rregulluar bolieri. Sasia e bllokuar ndodhej ende në ambientet e subjektit dhe inspektorët vendosën të lejojnë rihapjen e aktivitetit, pa dokumentuar prova të ri-analizimit ose masa të tjera të verifikueshme të vendosura si detyra nga inspektimi i mëparshëm. Grupi i

auditimit konstatoi se nuk ka asnjë dokument zyrtar që vërteton se detyrat e vendosura janë zbatuar plotësisht.

Sipas të dhënave nga AKU më datë 09.04.2025, ky subjekt u ri-inspektua dhe paraqiti kërkesë për asgjësimin e produktit të bllokuar.

- Në vitin 2022, u evidentua një rast mos konformiteti me kërkesat mikrobiologjike të përcaktuara në rregulloren për cilësinë e ujit të pijshëm. Më konkretisht, më 20.05.2022, gjatë një kampionimi të kryer në subjektin prodhues nga DRAKU-së Tiranë, një mostër e ujit të ambalazhuar me datë prodhimi 11.05.2022 u dërgua për analizë në laboratorin e NjVKSH Tiranë strukturë e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH). Sipas raportit të provës nr. 484, datë 20.05.2022, rezultoi se mostra ishte jo-konform për shkak të pranisë së (*Coliform total*) mbi normat e lejuara.

Pas këtij rezultati, AKU ngriti një grup inspektimi më 23.05.2022, i cili verifikoi situatën në subjekt dhe bllokoi sasinë prej 780 litrash të produktit të dyshuar. Po ashtu, u vendos pezullimi i pjesshëm i linjës së ambalazhimit dhe u vendos një gjobë prej 300,000 lekësh. Megjithatë, analiza e veprimeve të ndërmarra nga autoriteti kompetent tregon mangësi të dukshme pasi: AKU nuk zhvilloi një analizë të plotë të gjurmueshmërisë për të identifikuar burimin e ndotjes. Nuk u dokumentuan indikatorë teknikë që të ndihmonin në zbardhjen e shkakut, dhe mungoi koordinimi me OSHKSH për ri-kampionim të ri të ujit, siç parashikohet nga rregullorja për vlerësimin e riskut. Afatet për asgjësimin e produktit u caktuan pa një justifikim të qartë dhe nuk u respektuan nga subjekti. Ndjekja e mëtejshme e rastit nga ana e AKU-së ishte e dobët dhe e paefektshme.

Ky rast tregon për dobësi në funksionimin e mekanizmave të kontrollit zyrtar dhe mungesë koherence dhe rigoroziteti në ndjekjen e procedurave të plota të sigurisë ushqimore.

- Në vitin 2024, u identifikua një rast jo konform i ujit të ambalazhuar për treguesit organoleptikë, i cili vë në pikëpyetje efektivitetin dhe barazinë e veprimit institucional në raste të ngjashme të rrezikut për sigurinë ushqimore.

Pas denoncimeve nga konsumatorët në muajin shtator për aromë të rëndë të ujit të ambalazhuar në formatin 5 litra, AKU ndërmori një kontroll të menjëhershëm në subjektin prodhues, në magazinat qëndrore dhe në pikat e shitjes. Në vijim, më 27.11.2024, një mostër e ujit natyral e marrë nga një subjekt shitës u analizua nga laboratorin e Drejtorisë Rajonale të AKU Durrës (DRAKU Durrës) dhe rezultoi jo konform. Kjo sipas raport provës nr. 328/578, për shkak të aromës së rëndë dhe shijes jo karakteristike për ujë të pijshëm, pra mos konformitet për treguesit organo-shqisorë.

Pas kësaj, DRAKU-të në Durrës, Tiranë dhe Shkodër morën masa për gjurmimin e produktit, afishimin e njoftimeve për konsumatorët, si dhe bllokimin e sasisë së mbetur në subjekt. Nga procesi i kthimit, u evidentua një sasi uji i ambalazhuar prej 456 copë x 1.5 litra e rikthyer në subjektin prodhues. Megjithatë, nga kontrolli i mëvonshëm i DRAKU Shkodër, u konstatua se 31,200 copë të prodhuara në datën përkatëse ishin tashmë të shitura dhe të konsumuar nga publiku.

Pavarësisht rezultatit jo konform, nuk u krye asnjë analizë rrisht, nuk u evidentua shkak i devijimit cilësor dhe nuk u orientua subjekti për masa të detyrueshme korrigjuese, për të shmangur përsëritjen e rastit. Subjekti, nëpërmjet një kërkesë zyrtare, kundërshtoi rezultatet laboratorike, por kërkesa ishte jashtë afatit ligjor dhe nuk u mor parasysh. Megjithatë, deri në momentin e auditimit, sasia e bllokuar ende nuk ishte asgjësuar, dhe autoriteti kompetent (DRAKU Tiranë) nuk kishte ndjekur më tej zbatimin e masës, duke e kaluar përgjegjësinë te DRAKU Shkodër pa dokumentim të mjaftueshëm.

Në dallim nga rasti i mëparshëm i trajtuar me një tjetër subjekt në Tiranë, ku u vendosën dy masa administrative, në këtë rast nuk është marrë asnjë masë ndëshkuese, pavarësisht provave

të mos konformitetit dhe konsumit të produktit nga qytetarët. Kjo nxjerr në pah trajtimin me standarde të dyfishta nga AKU dhe drejtoritë rajonale për raste të ngjashme.

Mos përmbushja në kohë dhe me rigorozitet e procedurave për konstatimin, bllokimin, asgjësimin e produkteve, nga ana e autoritetit kompetent për garantimin e sigurisë ushqimore, rrishton konsumatorët dhe ulin besueshmërinë mbi funksionimin e sistemit të kontrollit në vend.

***Prej vitit 2023 në PIK Durrës nuk janë kryer marrje mostra për Ujin e pijshëm të ambalazhuar të importuar.***

Në vlerësimin e marrjes së mostrave nga strukturat e AKU-së në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK), u evidentua fakti se në PIK-un Durrës, nuk janë kryer marrje mostra për Ujin e pijshëm të ambalazhuar të importuar nga data 01.01.2023 dhe në vijim. Kjo me pretendimin se, në Udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Nr.19, datë 22.11.2022 “Për tarifën e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBZHR”, nuk ka tarifa shërbimi për analiza nga laboratorët e AKU-së. Ky udhëzim është vetëm për ISUV-in, ku në faqe 536, artikujt nr.110-116 janë paraqitur 7 lloje analizash dhe në kolonën “Matrica” është shënuar “Uji i pijshëm”, duke mos e specifikuar nëse është uji i pijshëm i rrjedhshëm apo i ambalazhuar?

Kjo ka sjellë paqartësi tek punonjësit e laboratorëve në DR AKU Durrës, të cilët e kanë ngritur shqetësimin tek drejtuesit e strukturës së AKU pasi është vënë në dukje mungesa e përshkrimit të saktë në këtë udhëzim të Ujit të pijshëm të ambalazhuar si dhe është kërkuar të shtohet “Ujë natyral” dhe “i gazuar”, “i ambalazhuar”. Nga verifikimet dhe intervistat e kryera nga grupi i auditimit, rezultoi se nuk është ndërmarrë asnjë hap nga AKU për përmirësimin dhe adresimin e mangësive në MZHR. Kjo ka sjellë një mungesë standartizimi të veprimeve të laboratorëve në raport me analizat që duhet të kryenin për mostrat e marra nga PIK me pagesë nga subjektet importuese. Evident është rasti që nga punonjësit e PIK-ut në Portin e Durrësit, janë marrë mostrat për ujin e importuar dhe nuk janë kryer analiza nga laboratorët përkatës. Kjo për mungesë tarife të caktuar specifikisht për analiza fiziko-kimike për ujin e pijshëm të ambalazhuar për periudhën nga data 01.01.2023 dhe në vijim.

Ndërkohë nga DR AKU Gjirokastrë në një rast është marrë mostra dhe kryer analiza duke i'u referuar tarifave të ISUV për llojin e analizës fiziko-kimike që kanë kryer. Pra siç shihet, mundësitë kanë qenë për të mos penguar për një kohë të shkurtër, deri sa të kryhej përmirësimi i Udhëzimit nga MBZHR. Pra kemi dy standarde në aplikim të tarifës. Gjithashtu konstatohet mos bashkëpunim e mos unifikim veprimesh nga Sektori i monitorimit të PIK-ut në AKU. Gjithçka mund të shmangej me një urdhëresë administrative të përkohshme. E njëjta situatë pa kryer marrje mostrash dhe kryerje analiza fiziko-kimike të ujit të pijshëm të ambalazhuar nga importi ka vijuar.

***Plani për marrjen e mostrave të ujit të pijshëm parashikon vetëm marrjen e mostrave në stabilimentet e territorit të DRAKU.***

Për marrjen dhe analizimin e mostrave DRAKU-të hartojnë planin vjetor i cili miratohet nga ministri përgjegjës për sigurinë ushqimore. Nga vizitat e zhvilluara në DRAKU Tiranë, Durrës, Fier dhe Gjirokastrë evidentohet se mostrat e ujit merren pothuajse vetëm në stabilimentet e ujit të cilat i përkasin juridiksionit të tyre territorial. Vetëm në raste dyshimi në subjekte tregtarë mund të merren mostra uji për analizim. Theksojmë se gjatë periudhës së verës zonat bregdetare janë gjithashtu të ekspozuara me shtimin e frekuentimit nga pushuesit. Inspektimet zyrtare të realizuara në terren konsistojnë në 25,258 të tilla të programuara sipas planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë rrisht dhe 6,789 të paprogramuara. Në nivel kombëtar rezultoi që plani vjetor i inspektimeve është realizuar në masën 86.2 %. Por konstatohet se, kontrollet zyrtare të planifikuara me bazë rrisht me objekt kontrollin dhe marrje mostra për ujin e pijshëm të ambalazhuar, në raport me numrin e kontrolleve zyrtare të planifikuara realizuar është shumë

i vogël dhe jonë proporcion me mundësitë dhe rëndësinë dhe peshën që ka produkti ushqimor Uji i pijshëm i ambalazhuar që prodhohet e tregtohet. Nuk ka një plan të kombinuar marrje mostre të paracaktuar, për ujin e ambalazhuar i cili prodhohet në territor por edhe për atë që tregtohet në këtë territor nga stabilimente jashtë qarkut si dhe ujin e importit në treg. Mungesa e një plani të kombinuar vjetor nuk garanton mbulimin e duhur në territor për këtë produkt.

**13. Gjetje nga auditimi:** Sipas rregullores për ujin e pijshëm, strukturat rajonale të shëndetit publik (NjVKSH-të) kanë detyrimin për të kryer monitorimin e jashtëm të ujit të pijshëm, përfshirë edhe ujin e ambalazhuar. Ky monitorim duhet të kryhet në përputhje me frekuencën e përcaktuar, bazuar në vëllimin e prodhimit të ujit. Nga auditimi rezultoi se, monitorimi nga AKU aktualisht kryhet vetëm mbi produktin final (shishe), ndërsa faza e prodhimit të ujit, nga burimi deri në ambalazh, nuk mbulohet. Strukturat rajonale të shëndetit publik (NjVKSH-të) e kanë ndërprerë monitorimin duke u mbështetur në interpretimin se, me ndryshimet në ligjin për inspektimin higjieno-sanitar, kompetencat i kanë kaluar Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Nga ana tjetër, AKU pretendon të kundërtën, se burimi dhe lënda e parë në stabiliment duhet të kontrollohet nga NjVKSH-të dhe nuk ka përfshirë në kontrollet e saj, fazat përpara daljes së produktit final. Pas ndryshime ligjore të vitit 2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si institucione qendrore nuk kanë ndërmarrë veprime për të qartësuar kompetencat dhe për të përditësuar rregulloren e ujit. Si pasojë, një segment i rëndësishëm i ujit të ambalazhuar mbetet i pambuluar, duke cenuar sigurinë për konsumatorin dhe integritetin e zinxhirit të sigurisë ushqimore.

**14. Gjetje nga auditimi:** AKU në kuadër të detyrimeve të tij ligjore për garantimin e sigurisë ushqimore, duhet të marr mostra për analiza mikrobiologjike dhe disa tregues fiziko-kimikë. Adresimi i mostrave bëhet në laboratorët rajonal të shëndetit publik (NjVKSH), pasi AKU nuk ka kapacitete të plota për kryerjen e analizave mikrobiologjike dhe disa tregues fiziko-kimik. Nga AKU dhe OSHKSH/NjVKSH nuk ka pasur bashkëpunim ndër institucional për kryerjen e analizave mikrobiologjike të ujit të ambalazhuar që prodhohet, trajtohet dhe tregtohet nga operatorët e biznesit ushqimor. Kjo ka krijuar mungesë të analizimit mikrobiologjik të produktit uji i pijshëm i ambalazhuar, ku për vitet 2023-2024 dhe 4 mujori 2025 nuk është pranuar asnjë mostër nga OSHKSH (NjVKSH-të) nga DR AKU në rrethe, kryesisht nga NjVKSH-të Tiranë dhe Durrës.

**15. Gjetje nga auditimi:** Në përputhje me rregulloren e ujit të pijshëm, miratuar me VKM-në nr. 379/2016, strukturat rajonale të shëndetit publik duhet të njoftojnë strukturën përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit (ISHSH) dhe institucionet e tjera përkatëse, në rast të konstatimit të rasteve jo-konforme të ujit të pijshëm të ambalazhuar. Pas ndryshimeve<sup>51</sup> ligjore të vitit 2020, kompetencat e ISHSH-së për inspektimet në higjieno-sanitare i kanë kaluar AKU-së. Gjatë periudhës 2020–2024, NjVKSH Tiranë ka evidentuar 26 raste të ujit të ambalazhuar me tregues mikrobiologjikë jo-konform, të cilat janë ri-testuar në 28 raste. Megjithatë, këto raste janë komunikuar vetëm me subjektet që kanë kërkuar analizat, dhe jo me AKU-në. Përfundimisht, NjVKSH Tiranë ka bërë njoftim tek AKU vetëm kur kërkesa për analizë vinte nga kjo e fundit. Mungesa e njoftimit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për rastet e ujit të ambalazhuar me tregues mikrobiologjikë jo konform, ka sjellë mungesë të ndërhyrjes institucionale në kohë, për ndalimin e shpërndarjes së produkteve dhe mos evidentimit të problematikave në pikat kritike në prodhim, potencialisht të rrezikshme për shëndetin.

---

<sup>51</sup> Ligji nr. 54/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektimin Sanitar”;

**16. Gjetje nga auditimi:** Sipas rregullores së ujit të pijshëm miratuar me VKM nr. 379/2016, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim mes tyre duhet të hartojnë udhëzime teknike<sup>52</sup> specifike për ujin e pijshëm të ambalazhuar. Nga ana e dy institucioneve së bashku, nuk janë hartuar udhëzues teknik për kriteret që duhet të plotësojnë stabilimentet për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit të pijshëm të ambalazhuar.

**17. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2021–2024, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka trajtuar raste të ujit të pijshëm të ambalazhuar që kanë rezultuar jo konform për tregues mikrobiologjikë ose organo-shqisore, por ndjekja e këtyre rasteve ka qenë e fragmentuar, jo konsistente dhe me mangësi procedurale. Në vitin 2021 dhe 2022, në dy raste të identifikuar përkatësisht në DRAKU Elbasan dhe Durrës, ndonëse u morën masa për bllokim produkti dhe gjobitje, AKU nuk zhvilloi një analizë gjurmueshmërie për të identifikuar shkakun e ndotjes dhe nuk bashkëpunoi me laboratorin për ri-analizim, duke vepruar në mënyrë të pjesshme dhe pa ezauruar të gjitha etapat. Në vitin 2024, në rastin e identifikuar në DRAKU Tiranë, për një rast të aromës jo karakteristike në ujë, megjithëse u kryen disa masa në terren dhe u rikthyen sasi të produktit, nuk u ndërmer asnjë analizë risku, nuk u vendosën masa ndëshkuese, dhe nuk u orientua subjekti për veprime korrigjuese. Krahasuar me raste të tjera të trajtuara më rreptësisht, kjo situatë tregon për trajtim të pabarabartë të subjekteve, mungesë transparence dhe dobësi në mekanizmat e kontrollit zyrtar, duke ulur ndjeshëm besimin në mbrojtjen institucionale të konsumatorit.

**18. Gjetje nga auditimi:** Kontrollat zyrtare të AKU-së dhe marrja e mostrave për ujin e pijshëm të ambalazhuar kryhet me frekuencën një herë në vit dhe i kufizuar vetëm në stabilimentin që kryen aktivitet prodhim/tregtim në territorin/juridiksionin që kanë DRAKU-ve. Kjo procedurë është dhe për DRAKU-të që kanë intensitet të lartë konsumi uji të pijshëm të ambalazhuar gjatë sezoneve turistike. Mënyra aktuale nuk mundëson inspektim të parashikuar mbi markat e tjera të ujit të ambalazhuar të prodhuar në vend të cilat janë prezente në territor.

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se, në Pikën e Inspektimit Kufitar (PIK) Durrës, nga data 01.01.2023 dhe në vijim, nuk janë analizuar mostra për “ujin e pijshëm të ambalazhuar” të importuar. Kjo me pretendimin se, në Udhëzimin nr.19, datë 22.11.2022 “Për tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBZHR” mungojnë tarifat e shërbimit për analizimin fiziko-kimik të këtij produkti. DRAKU Durrës lidhur me këtë situatë ka vënë në dijeni Sektorin e Laboratorit në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU. Ndërkohë, nga kjo e fundit nuk janë marrë masa për sqarimin e situatës apo përcjelljen e problematikës drejt ministrisë për zgjidhje. Nuk është nxjerrë asnjë urdhëresë për rregullimin e situatës dhe kryerjen e analizimeve për produktin e importuar, çka cenon sigurinë e konsumatorit.

**3. Konkluzioni:** Kontrolli i ujit të pijshëm të ambalazhuar është i fragmentuar dhe me boshllëqe të rëndësishme në fazat e prodhimit dhe hedhjes së tij në treg. Kjo për shkak të mungesës së koordinimit ndërinstitutional, mungesës së udhëzimeve teknike dhe zbatimit të pjesshëm të detyrimeve ligjore. Mos bashkëpunimi për analizat mikrobiologjike, mos raportimi i rasteve jo konform dhe ndjekja në vijueshmëri e tyre nga AKU kanë cenuar funksionimin e sistemit zyrtar të kontrollit.

---

<sup>52</sup> Referuar nenit 4 pika 1/dh dhe 2, të VKM nr. 379 datë 25.05.2016 Rregullorja “Cilësia e ujit të pijshëm”.

**13.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrin masa, të rishikojnë dhe qartësojnë detyrat ndërinstitucionale për monitorimin e ujit të pijshëm të ambalazhuar, në të gjitha fazat, nga burimi deri në tregtimin e tij.

**Brenda datës 31.03.2026**

**14-15.1 Rekomandimi:** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrin masa, të analizojnë dhe vlerësojnë situatën e krijuar ndërmjet dy institucioneve të varësisë, AKU/OSHKSH, duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete për mungesë bashkëpunimi ndër institucional në pranimin e mostrave për analiza mikrobiologjike të ujit të pijshëm të ambalazhuar si dhe të ndërmarrin iniciativa administrative e ligjore për të hartuar Udhëzim/Marrëveshje të përbashkët bashkëpunimi e cila:

- të jetë detyruese për institucionet vartëse, ku të jenë përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrat e secilës palë lidhur me ujin e pijshëm të ambalazhuar.
- të vendosi mekanizma detyrues dhe të standardizuar raportimi për të gjitha rastet e ujit të pijshëm të ambalazhuar që rezultojnë jo konform.

**Brenda datës 31.12.2025**

**16.1 Rekomandimi:** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të hartojnë dhe miratojnë një udhëzues teknik kombëtar për stabilimentet e ujit të pijshëm të ambalazhuar, në përputhje me përcaktimet në rregulloren e ujit të pijshëm miratuar me VKM nr. 379/2016 dhe praktikat e mira të BE-së.

**Brenda datës 31.03.2026**

**17.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për tre rastet e konstatuara me shkelje apo mos zbatim të plotë të procedurës lidhur me cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar, në DRAKU Elbasan, Durrës Tiranë, përkatësisht në vitet 2021, 2022 dhe 2024, por edhe në të gjitha rastet e ngjashme, të udhëzojë dhe monitorojë DRAKU-të, në përmbushjen e plotë të detyrimit të tyre ligjor deri në asgjësimin e plotë të produktit me qëllim;

- shmangien e vonesave në procedurat parandaluese dhe asgjësuese në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse;
- marrjen e masave administrative përkatëse;
- nxjerrjen e përgjegjësiive individuale të strukturave për secilin rast.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**18.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrë masa dhe të rishikojë planin e inspektimeve me bazë risku dhe të orientojë njësitë e varësisë me urdhëresë administrative. Kjo për të rritur frekuencat e kontrolleve zyrtare dhe marrjen e mostrave të ujit të pijshëm gjatë sezonit turistik, jo vetëm për stabilimentet, por edhe për markat e tjera të ujit të pijshëm të ambalazhuar prodhim vendi e importi, që tregtohen në zonat e juridiksionit të DRAKU-ve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**19.1 Rekomandimi:** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për plotësimin e Udhëzimit nr.19, datë 22.11.2022 “Për tarifën e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBZHR” i ndryshuar, me tarifën për shërbim laboratorik që kryhet nga DRAKU-të, për kryerjen e analizave fiziko-kimike të ujit të pijshëm të ambalazhuar që importohet e tregtohet nga operatorët të biznesit ushqimorë (OBU).

**Menjëherë**

**19.2 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrë masa të menjëhershme dhe të nxjerrë një Urdhëresë qarkulluese, ku të udhëzohen laboratorët e DRAKU-ve mbi përdorimin e përkohshëm të tarifave sipas llojit të analizave fiziko-kimike që kryhen pranë laboratorëve në vartësi të AKU-së, deri në plotësimin e udhëzimit mbi tarifafat.

**Menjëherë**

### **5.3 Pyetje e auditimit: A garantohet informacioni i plotë dhe transparencja për qytetarin lidhur me ujin e ambalazhuar ?**

Uji i pijshëm i ambalazhuar rregullohet nga një kuadër rregullator specifik i cili është në përdorim prej një periudhe relativisht të gjatë. Ky kuadër përfshin disa vendime të Këshillit të Ministrave mbi cilësinë dhe etiketimin si dhe disa urdhra të ministrit përgjegjës për fushën e ushqimit. Më poshtë paraqiten aktet mbi të cilat bazohet kjo veprimtari.

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 379 datë 25.05.2016 Rregullorja “Cilësia e ujit të pijshëm”;
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”;
- ✓ Urdhër Ministri nr. 314, datë 27.10.2010 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e listës, kufijve të përqendrimit dhe kërkesat për etiketimin, për përbërësit natyralë të ujërave minerale dhe kushtet për përdorimin e ajrit të pasuruar me ozon për trajtimin e ujërave minerale natyrale dhe ujërave të burimit”;
- ✓ Urdhër Ministri nr. 266 datë 29.08.2011 “Për miratimin e rregullores për industrializimin dhe tregtimin e ujërave mineralë natyralë”;
- ✓ Urdhër Ministri nr. 13 , datë 22.11.2012 “Për miratimin e rregullores “për përcaktimin e kushteve të përdorimit të aluminit aktiv, për largimin e florit nga uji mineral natyral dhe uji burimit”.

Në këto akte përcaktohen rregullat bazë mbi kategorizimin e ujërave, përmbajtjen e tyre, llojet e analizimit, proceset që mund/duhet ti nënshtrohen, gjatë fazës së prodhimit si dhe informacionet e nevojshme që duhet të përmbajë produkti final me qëllim informimin e duhur të konsumatorit.

Uji mineral natyral nënkupton, ujin e pastër mikrobiologjikisht, me origjinë nga një pus ose shtresë nëntokësore dhe që nxirret nga toka nëpërmjet një ose shumë daljeve natyrore apo edhe puseve të shpuara. Ky ujë dallon nga uji i pijshëm i zakonshëm nga pastërtia origjinale, përmbajtja e elementëve dhe efektet pozitive të tij për shëndetin. Uji mineral ambalazhohet vetëm nëse plotësohen disa kushte specifike për garantimin e mbrojtjes nga rreziku i ndotjes, higjienike, infrastrukturës së përpunimit etj. Ai mund t`i nënshtrohet edhe shtimit të gazit karbonik. Ai mund ti nënshtrohet trajtimeve të përcaktuara në përputhje me kërkesat e sigurisë ushqimore, por pa ndryshuar karakteristikat natyrale të ujit. Ambalazhet që do të përdoren për të duhet të jenë të përshtatshme për të shmangur çdo mundësi falsifikimi apo ndotje.

Nëse ky ujë plotëson kërkesat e përcaktuara në rregulloren për industrializimin e ujërave mineralë dhe rregullores së përgjithshme për cilësinë e ujit të pijshëm, mbi ambalazh në të gjitha rastet pas plotësimit të kushteve duhet të shënohet një nga emërtimet:

- “ujë mineral natyral”,
- “ujë mineral natyral, me gaz nga burimi”,
- “ujë mineral natyral, i përforcuar me gaz nga burimi”,
- “ujë mineral natyral i gazuar”.

Kur uji i nënshtrohet trajtimit fizik të largimin të pjesshëm të gazit karbonik me metoda fizike në etiketë shtohet shënimi “plotësisht i degazuar” ose “pjesërisht i degazuar”  
Në rast se uji mineral natyral ambalazhohet në burim dhe plotëson kërkesat e parashikuara ai klasifikohet si “Ujë Burimi”.

Sipas këtyre akteve ndalohet shënimi në etiketë i treguesve mbi vetitë parandaluese dhe kuruese të ujit mineral. Ndërkohë ndalohet dhe ambalazhimi i ujërave sipërfaqësorë qofshin këto të trajtuara.

***Uji i ambalazhuar nuk është pjesë e raporteve që ISHP harton për ujin e pijshëm.***

Sipas rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, parashikohet se, për informimin e konsumatorëve strukturat rajonale të shëndetit publik duhet të përgatisin raportin vjetor mbi cilësinë e ujit të pijshëm në rajonin e tyre. Ndërkohë Instituti i Shëndetit Publik duhet të përgatisë raportin vjetor kombëtar mbi cilësinë e ujit të pijshëm, ndërsa çdo tre vite Ministria e Shëndetësisë përgatit raportin trevjeçar. Konstatohet se, raportet e hartuara janë ato vjetore nga ISHP, të cilat nuk e përfshijnë ujin e pijshëm të ambalazhuar. Raporti përfshin vetëm rrjetin e furnizimit të shoqërive Ujësjellës-Kanalizime, bazuar në data bazën e të dhënave mujore/vjetore me të dhënat e monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm në ujësjellësit publikë të kryer nga njësitë vendore. Sipas përgjigjeve të MSHMS, trajtohet se, NJVKSH-të nuk ushtrojnë funksione monitoruese apo kontrolluese mbi cilësinë e këtij uji, nuk hartohen raporte periodike dhe vjetore në këtë drejtim dhe kjo detyrë i përket AKU. Nga ana tjetër rregullorja e ujit trajton pikërisht këto institucione për hartimin e tyre dhe informimin e publikut mbi situatën. Ndryshimet e ndodhura në strukturën e ISHP e cila tashmë funksionon vetëm në nivel qendror, si dhe kalimi i kompetencave vendore tek OSHKSH-të rajonale dhe NJVKSH-të kanë krijuar paqartësi në këto struktura për kryerjen e monitorimit edhe publikimin e të dhënave për ujin e pijshëm të ambalazhuar në rang vendi.

***AKU nuk ka një rregullore të brendshme për publikimin e rasteve me rrezik.***

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si institucioni përgjegjës për produktet ushqimore ku përfshihet edhe uji i pijshëm i ambalazhuar nuk disponon një kuadër rregullator mbi mënyrën e publikimit të rasteve me rrezik serioz për shëndetin. Në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e saj nuk trajtohen masat që duhet të merren për informimin e publikut, ndërkohë që kjo parashikohet qartësisht në ligj.<sup>53</sup> Në praktikë për të gjitha rastet që nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Vlerësimit të Riskut, vlerësohen që një rast konkret për analizat jo konform duhet të publikohet, kryhet njoftimi me e-mail në Drejtorinë e Komunikimit dhe më pas është Sektori i Informimit të Publikut, i cili kryen publikim menjëherë të rastit. Për periudhën 2020-2024 nga këto drejtori nuk ka pasur raste konkrete për publikim. Ndërkohë janë të paktën tre raste të konstatuara me rezultate analizash jo konform nga DRAKU-të, për të cilat nga ana e strukturave të AKU nuk është vlerësuar publikimi në faqen zyrtare të institucionit apo njoftim të publikut.

Për problematikat që evidentohen nga konsumatorët AKU disponon disa mjete të informimit publik ndër të cilat përmendim:

*E-maili zyrtar [info@aku.gov.al](mailto:info@aku.gov.al)*

*Numri i gjelbër 08007575*

*Kordinatori për të Drejtën e Informimit*

Për periudhën vitet 2020-2024 në adresë të AKU janë paraqitur disa denoncime dhe konkretisht:

<sup>53</sup> Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008 “PËR USHQIMIN”, neni 8 “Parimet e transparencës”:

-Për vitin 2020 janë bërë 2 denoncime pranë [info@aku.gov.al](mailto:info@aku.gov.al) për të njëjtin kompani uji , me ankesë si “ujë i pasigurt për konsum”.

-Për vitin 2024 janë bërë dy denoncime për të njëjtin kompani uji njëra nga një media referuar denoncimeve të qytetarëve pranë tyre, pa referuar denoncimet – për përmbajtje copa plastike brenda ambalazhit të ujit 5L, dhe një denoncim nga një qytetar për të njëjtin kompani uji, për aromë të rëndë po në këtë format ambalazhimi, të cilat janë ndjekur nga strukturat e AKU.

Të dhënat e vetme që AKU ka në faqen e saj është një seksion i cili trajton ekspozimin ndaj substancave kimike në plastikë dhe hapat që duhet të ndërmerren:

Megjithatë, informacionet për qytetarin lidhur me qasjen që ai duhet të ketë lidhur me ujin mineral natyral të ambalazhuar nga institucionet shtetërore të përfshira në auditim është i pakët dhe thuajse i munguar. Pra mënyra si të dallohet uji i përshtatshëm për konsumim, përmbajtjen e elementëve dhe efektet pozitive dhe ato negative në shëndet sipas elementëve.

Mungon veprimtaria kërkimore dhe shkencore nga institucionet si ISHP, NJVKSH, AKU dhe AMBU si dhe nuk shihen gjurmë të bashkëpunimit të tyre me katedrat universitare lidhur me ujin e pijshëm të ambalazhuar.

### ***Etiketat e ujit të ambalazhuar janë të pa standardizuara sa i përket përmbajtjes.***

Nga të dhënat e paraqitura nga subjektet nën auditim rezulton se etiketat e miratuara nga DRAKU-të për ujin e pijshëm të ambalazhuar nuk janë të standardizuara për përmbajtjen e tyre. Në to evidentohen elementë të cilat mund të konfuzojnë lehtësisht konsumatorin dhe konkretisht në disa raste:

- etiketat e ujit në pjesën kryesore përmbajnë emërtim të ujit në gjuhë të huaj të tilla si “Premium water”, “Sparkling water”, etj;
- nuk pasqyrohen qartë emërtimet e ujit të parashikuara në rregulloren nr. 266/viti 2011;
- nuk arrihet të kuptohet nëse është “ujë burimi” pra ujë i ambalazhuar në burim apo në stabiliment larg burimit;
- si referencë për analizën e përmbajtjes në etiketë pasqyrohen ISHP, NJVKSH, laboratorë privatë vendas, laboratorë të paemërtuar, si dhe institucione shtetërore të huaja të shëndetit publik<sup>54</sup>;
- paraqiten përmbajtje të mineraleve të cilat janë jashtë normave të përcaktuara<sup>55</sup>;
- nuk paraqiten informacione mbi trajtimet e ujit.
- Nuk ka një afat kohor të përcaktuar për ri-kryerjen e analizave për etiketimin.

Këto mangësi e pasaktësi e konfuzojnë konsumatorin mbi vlerat ushqyese të ujit dhe e bëjnë të vështirë përzgjedhjen e ujit më të favorshëm për ta.

Gjithashtu nga ana e DRAKU-ve nuk disponohen të gjitha etiketimet e miratuara përpara se ky proces tu kalonte këtyre strukturave. Inspektorët nuk dispononin të dhënat e plota për etiketime të subjekteve të ndryshëm tregtarë të ujit të pijshëm që ushtronin aktivitet në territorin e këtyre DRAKU-ve.

**20. Gjetje nga auditimi:** Sipas Rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, strukturat shëndetësore duhet të hartojnë dhe publikojnë raporte vjetorë dhe trevjeçarë në nivel kombëtar mbi cilësinë e ujit të pijshëm. Në këto raporte nuk është përfshirë uji i pijshëm i ambalazhuar. Nga auditimi konstatohet se, NJVKSH, ISHP dhe MSHMS si hartues të tyre paraqesin paqartësi sa i takon rolit dhe detyrimeve që këto institucione kanë mbi këtë proces. Ndërkohë ato janë të përfshira

<sup>54</sup> Raste të DRAKU Gjirokastër;

<sup>55</sup> Pika 22 dhe Shtojca 3 e Rregullores nr. 266 datë 29.08.2011 “Për miratimin e rregullores për industrializimin dhe tregtimin e ujërave mineralë natyralë” përcakton se, treguesit si Bikarbonatet, Sulfatet, Kloruret, Kalciumi, Magnezi, Fluori etj, lejohet të shënohen në etiketë nëse plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë shtojcë;

direkt në proceset e analizimit të ujit, dhënien e lejeve nga këshillat e baseneve ujore për ujë të ambalazhuar, përcaktimin e zonave higjieno-sanitare etj.

**21. Gjetje nga auditimi:** Rregullorja aktuale mbi organizimin dhe funksionimin e AKU, nuk trajton hapat që duhen ndjekur për informimin e publiku në rastet ku shëndeti i njerëzve mund të vihet në rrezik. Ndërkohë që ligji bazë për ushqimin e trajton qartë informimin, si parim të transparencës që ndikon drejtpërdrejtë në parandalimin e problematikave. Në praktikën aktuale të ndjekur nga institucioni paraprakisht bëhet një vlerësim nga sektorët përkatës dhe nëse gjykohet prej tyre bëhet publikimi i informacionit. Nga tre raste të konstatuara jo konform gjatë periudhës vitet 2020-2024 për ujin e pijshëm të ambalazhuar, për asnjë prej tyre nuk është bërë informim publik. Mungesa e përcaktimeve dhe hapave të qartë në kuadrin rregullator ndikon në trajtimin e pa standardizuar të rasteve për të informuar konsumatorin.

**22. Gjetje nga auditimi:** Etiketat e miratuara/pranuara nga DRAKU-të për ujin e pijshëm të ambalazhuar paraqiten të pa standardizuara sa i përket përmbajtjes së tyre. Në një pjesë të tyre, në fushëpamjen kryesore evidentohen emërtime të ujit vetëm në gjuhë të huaj, nuk përdoren terma standard sipas përcaktimeve të rregullores<sup>56</sup> mbi industrializimin dhe tregtimin e ujrave mineralë natyralë. Treguesit e mineraleve të ujit nuk përmbushin normat e rregullores për tu paraqitur në etiketë. Mungojnë informacionet mbi trajtimin e ujit. Analizat e detyrueshme të treguesve në etiketën e ujit të ambalazhuar paraqiten nga burime të shumëllojshme. Ndër to përmendim, NJVKSH, ISHP, pa emërtim laborator, laboratorë privatë brenda vendit, por ka dhe raste kur analizat e paraqitura në etiketë janë të kryera vetëm në institucione shtetërore të huaja të shëndetit publik dhe jo në institucionet e shtetit shqiptar. Mungesa e uniformitetit të përmbajtjes së tyre ka ndikime të rëndësishme për informimin e qartë dhe të plotë të konsumatorit mbi produktin.

**23. Gjetje nga auditimi:** DRAKU-të nuk dispononin një bazë të konsoliduar të dhënash për etiketat e miratuara/pranuara për ujin e pijshëm të ambalazhuar që tregtohet në vend. Inspektorët e tyre nuk kanë mundësi direkte për të verifikuar etiketat e ujit të ambalazhuar që prodhohet në stabilimente në rajone të tjera brenda vendit, por që tregtohen nën juridiksionin territorial të tyre. Mungesa të dhënave në kohë reale ndikon në drejtim të konstatimit në kohë të parregullsisive të mundshme si dhe garantimit të sigurisë për konsumatorin.

**4. Konkluzioni:** Nga ana e institucioneve përgjegjëse, nuk garantohet në mënyrë të plotë transparenca e nevojshme për qytetarin lidhur me ujin e pijshëm të ambalazhuar. Nuk ka standardizime për mënyrën e komunikimit me publikun dhe mungojnë rregullat e qarta në këtë drejtim. Ka paqartësi të dukshme lidhur me kompetencat sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore dhe mungesë bashkëpunimi mes institucioneve pjesë të procesit.

**20.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe strukturat e saj të varësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor të marrin masa dhe të përfshijnë edhe ujin e ambalazhuar, në raportet vjetore dhe tre vjeçare që hartohen për ujin e pijshëm, me qëllim informimin e konsumatorit mbi situatën.

**Në vijimësi**

**21.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të hartojë dhe propozojë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ndryshimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e

<sup>56</sup> “Rregullore për industrializimin dhe tregtimin e ujrave mineralë natyralë” miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 266 datë 29.08.2011;

AKU”, duke shtuar një seksion të posaçëm për vlerësimin e rasteve dhe masat përkatëse për informimin e publikut, në përputhje me parimet e transparencës të parashikuara në ligjin “Për ushqimin”.

**Brenda datës 31.03.2026**

**22.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrë masa për të standardizuar përmbajtjen e etiketave të ujit të pijshëm të ambalazhuar në vend, referuar “Rregullores për industrializimin dhe tregtimin e ujërave mineralë natyralë”, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.266 datë 29.08.2011, me qëllim informimin e plotë të konsumatorëve dhe shmangien e abuzimeve.

**Brenda datës 31.03.2026 dhe në vijimësi**

**23.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrë masa për të krijuar një bazë të konsoliduar të dhënash për etiketat e ujit të pijshëm të ambalazhuar, e cila mund të përdoret nga inspektorët e AKU, me qëllim garantimin e përmbajtjes së tyre referuar kuadrit ligjor e rregullator dhe informimin e drejtë të konsumatorit për këto produkte.

**Brenda datës 31.03.2026 dhe në vijimësi**

## **6. SHTOJCAT**

### **6.1-Trajtimi i observacioneve të paraqitura nga subjektet nën auditim.**

Në vijim të Projektraportit të auditimit të dërguar në subjektet e audituara, janë paraqitur observacione nga Ministria e Shëndetësisë, Mbrojtjes Sociale, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

*- Ministria e Shëndetësisë, Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 286/3 prot, datë 14.08.2025 regjistruar në KLSH me nr. 123/7 prot, datë 19.08.2025 ka paraqitur disa komente dhe shpjegime lidhur me Projektraportin e auditimit. Në mënyrë të përmbledhur i trajtojmë si më poshtë vijon:*

Mbi rekomandimin nr. 2.1 faqe 30 të Projektraportit nga ana e MSHMS kërkohet vendosja e AMBU si institucion udhëheqës për zbatimin e rekomandimit dhe jo të dyja së bashku me MSHMS. Kjo arsyetohet me përcaktimet në nenin 32 të Ligjit nr. 29/2024 “Për burimet ujore” pika 2 dhe 3 e saj.

#### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Ligji nr. 29/2024 “Për burimet ujore” në pikën 2 të tij përcakton se, AMBU së bashku me MSHMS dhe disa institucione të tjera përcakton kufijtë e zonave të mbrojtjes higjiëno-sanitare dhe kërkesat që duhen respektuar. Pika 3 e po këtij neni trajton se, është MSHMS e cila bën propozimin në Këshillin e Ministrave për miratimin e tyre. Pikërisht bazuar në këtë pikë të dy institucionet kanë përgjegjësitë respektive për mbylljen e procesit. Për sa më sipër observacioni nuk pranohet për të kryer ndryshime në këtë rekomandim.

Nga ana e MSHMS kërkohet që të ri-shikohen afatet për zbatimin e rekomandimeve për rekomandimet 2.1 nga “Menjëherë” në “Menjëherë dhe në vijimësi”; për rekomandimin 3.1 nga “Brenda datës 31.12.2025” në “Menjëherë dhe në vijimësi”; për rekomandimin 8.1 nga “Menjëherë dhe në vijimësi” në “Në vijimësi”. Këto ndryshime kërkohen me arsyetimin se, duhet më tepër kohë për përcaktimin dhe miratimin e zonave të mbrojtjes higjiëno-sanitare, nevojitet kohë për propozimin e akteve rregullatorë etj.

### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Nisur nga rëndësia e çështjes dhe mangësitë dhe/ose paqartësitë në kuadrin ligjor e rregullator, si dhe efektet që ato krijojnë gjatë zbatimit të tyre, vendosja e afatit menjëherë ka si qëllim nxitjen e institucioneve për nisjen e menjëhershme të procedurave. Kjo për të arritur më pas në përmbushjen e plotë të rekomandimit. Gjithashtu afatet shërbejnë edhe për monitorimin e vlerësimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimit nga subjektet e audituara në një fazë të dytë. Për sa më sipër nuk evidentohet domosdoshmëria për ndryshime në to.

Për rekomandimin 12.1 MSHMS trajton se deri në vitin 2026 do të përgatitet një akt nënligjor që do të zëvendësojë VKM nr. 379 viti 2016. Kjo në vijim të projektit EU 4Rivers. Për këtë projekt MSHMS referon AMBU si autoritet koordinues.

### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Për sa më sipër, referuar procesit për rishikimin e VKM nr. 379 edhe me shtimin e ndotësve të rinj, afati për zbatimin e rekomandimit pranohet të ndryshohet deri më 31.07.2026.

-Për rekomandimin 13.1 MSHMS trajton se ajo dhe ISHP nuk janë institucione përgjegjëse për monitorimin e ujit të ambalazhuar.

### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Për sa trajtohet në gjetjen nr. 13 dhe rekomandimin përkatës sqarojmë se, rekomandimi i referohet nevojës për qartësim të kompetencave të secilit institucion. Nisur kjo nga kuadri rregullator aktual, por dhe ndryshimet ligjore të cilat kanë prodhuar paqartësi në kuptim dhe zbatim të tyre. Paqartësitë paraqiten në kompetencat mbi kontrollin/inspektimin dhe analizimit të segmentit nga burimi në godinën e stabilimentit, kushteve të ruajtjes dhe përdorimit të lëndës së parë në stabiliment, mbulimin e procesit teknologjik të prodhimit, kontrollin e kushteve të transportimit, kompetencat e secilit institucion në pikat e shitjes, procesin e ndërhyrjes në rastet e konstatimit të problematikave epidemiologjike, etj. Situata paraqet nevojë për qartësim fillimisht midis institucioneve dhe më tej brenda secilit prej tyre. Për sa më sipër nuk evidentohet domosdoshmëria për ndryshime.

*-Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore me shkresën nr. 1863 prot, datë 19.08.2025 regjistruar në KLSH me nr. 123/8 prot, datë 20.08.2025 ka dërguar disa komente dhe shpjegime lidhur me Projektraportin e auditimit. Në mënyrë të përmbledhur komentet i trajtojmë si më poshtë vijon:*

Për rekomandimin 2.1 nga ana e AMBU trajtohet pamundësia e zbatimit të menjëhershëm të rekomandimit. Kjo pasi, për përcaktimin e zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare kërkohet ekspertizë dhe bashkëpunim me ministritë e linjës. Ky proces duhet të ecë paralelisht me hartimin e planeve të menaxhimit. Në çdo subjekt që aplikon është kërkuar nga AMBU kushti i përcaktimit të brezave higjieno-sanitar pavarësisht se ky nuk ishte një detyrim.

### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Kuadri ligjor paraqet detyrimin që institucionet kanë për përcaktimin e zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare për burimin ujor. Për këtë, por edhe për rëndësinë që këto zona kanë në mbrojtjen e burimit ujor është vlerësuar nisja e menjëhershme e veprimtarive sipas përgjegjësive institucionale për përcaktimin dhe miratimin e tyre. Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Për gjetjen nr. 3 sqarojmë se, leja e përdorimit për ujë sipërfaqësor është gabim në zbardhje. Për këtë ju paraqesim Vendimin dhe oponencën nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Ndërsa lidhur me rekomandimin 3.1 AMBU shprehet dakord por kërkohet rishikim i afatit për zbatimin të rekomandimit pasi në fillim të vitit 2026 eksperti i projektit EU4Rivers i cili asiston AMBU dhe MSHMS do të dorëzojë veç të tjerash dhe draftin për ndryshimet të akteve. Në këto rrethana është i pamundur përfundimi i këtyre akteve brenda këtij viti.

#### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Duke qenë se këto akte kanë mbivendosje dhe mund të prodhojnë efekte të gabuara, kërkojmë njehsimin sa më parë të tyre. Sa i përket rishikimit të kuadrit në tërësi, analizat, konkluzionet apo vendimmarrjet mund të prodhojnë ato mund të kërkojnë ndryshime strukturore, ato mund të realizohen kur këto procese të përfundojnë. Theksojmë gjithashtu se afati i kërkuar nga ana juaj ndryshon nga ai i kërkuar nga MSHMS, më sipër.

-Për gjetjen nr.4 dhe rekomandimin nr. 4.1 lidhur me dhënien e lejeve për burimet ujore AMBU nuk shprehet dakord. Kjo pasi aktet ligjore nuk parashikojnë një procedurë që institucioni duhet të zhvillojë për ndjekjen e parimeve të konkurrueshmërisë. Në këto rrethana gjykojmë se përfitimi i lejes së përdorimit të burimit ujor edhe për imbotilim është përfituar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po kështu në çdo rast, akti nënligjor duhet të ndryshohet dhe si i tillë për sa parashtruar edhe në rekomandimin 3.1 afati i vendosur është i pamundur për zbatim.

#### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sqarojmë se, thelbi mbi gjetjen nr.4 dhe rekomandimin nr. 4.1 ka të bëjë me mungesën e parashikimit e kuadrit ligjor e rregullator në fuqi dhe jo me veprimet e AMBU. Për vetë rëndësinë që ky produkt ka, barazisë për përfitimin e të drejtave publike, referuar ligjit për koncesionet, kriteret e vendosura nga procedurat e prokurimit publik dhe jo vetëm, si dhe duke gjykuar rolin që auditimet e performancës kanë në përmirësimin e proceseve është vlerësuar që AMBU të rishikojë këtë proces dhe në përfundim të arrijë në një konkluzion. Për këtë mund të shfrytëzohet edhe ekspertiza ligjore në kuadër të aktiviteteve të projektit EU4Rivers me një afat të ri për zbatimin e rekomandimit. Për sa më sipër observacioni merret në konsideratë pjesërisht, për afatin e zbatimit.

Për rekomandimin nr. 4.2 lidhur me rishikimin e profileve të punës AMBU nuk shprehet dakord me argumentimin se, ka filluar puna për hartimin e strukturës dhe organikës së re që do të miratohet. Në vijim të finalizimit të saj, do të bëhen përshkrimet e punës. Në këtë kuadër është i pamundur realizimi i rekomandimit brenda afatit të vendosur.

#### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Lidhur me pretendimin e AMBU, grupi i auditimit do të rishikojë afati për zbatimin e rekomandimit. Observacioni pranohet.

Për rekomandimin nr. 6.1 lidhur me të dhënat mbi shitjet e kryera AMBU nuk shprehet dakord me argumentimin se, mënyra e matjes së ujit bëhet me matës automatik. Është i vështirë krahasimi i vlerave faturimeve me të dhënat e sasive që deklarohen në shitje tek tatimet apo në doganë. Këto mospërputhje mund të sjellin konfuzion në analizat vjetore.

#### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sqarojmë se, trajtimi ynë i referohet rasteve të luhatjeve të konsiderueshme në të dhënat e konsumit të ujit. Për këtë të dhënat e institucioneve shtetërore përbëjnë një bazë të mirë të dhënash dhe informacioni se sa janë sasi të që subjektet kanë shitur, pasi uji nuk është lëndë e parë që magazinohet gjatë përpara ambalazhimit. Këto të dhëna të marra në mënyrë permanente

do të ndihmojnë vlerësimin jo vetëm mbi sasinë e ujit të nxjerra por edhe mbi sasinë e ujit të destinuar në treg, pikërisht për qëllimin mbi të cilin është dhënë leja. Vlerësimet apo rivlerësimet e sasive patjetër duhet ti nënshtrohen analizimit të kontrollorëve për nxjerrjen e konkluzioneve. Të dhënat e këtyre institucioneve janë gjithashtu të rëndësishme për analizimin e risqeve për kontroll por edhe për të vlerësuar përmbushjen e kushteve të planeve të biznesit gjatë procesit të ri-dhënien e lejeve. Sa më sipër këto të dhëna nuk krijojnë mundësojnë më tepër informacion për strukturat e AMBU-së. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë për ndryshime në material.

Për rekomandimin nr. 6.1 lidhur me faturimet mujore, AMBU nuk shprehet dakord. Kjo argumentohet me faktin se, faturimi 3-mujor është i parashikuar, kapacitetet njerëzore janë të kufizuara dhe ka vakanca në staf, krijon kosto shtesë, mungojnë automjetet. Sipas AMBU, duke pasur në konsideratë këto është menduar dhe miratuar kjo procedurë e veçantë faturimi.

#### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sqarojmë se rregullisht faturimi i ujit duhet të bëhet rregullisht çdo muaj, për arsyet të cilat janë paraqitur edhe në material. Problematikat mbi vendet vakante të punonjësve të saj, mungesa e mjeteve, janë evidente. Megjithatë, lidhur me menaxhimin e këtij procesi AMBU duhet të vlerësojë mekanizmat e mundshëm për të garantuar faturimin sipas akteve rregullative. Për rekomandimin nr. 7.1 lidhur me operatorët të cilët disponojnë leje për përdorimin e burimit ujor për ambalazhim me bot, AMBU shprehet se është pjesërisht dakord. Theksohet se do të vlerësohet situata dhe kushtet teknike në të cilat operojnë subjektet e pajisur me leje, në përputhje me kaudrin ligjor në fuqi.

#### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

AMBU nuk paraqet qartë në observimin e saj, ku është dakord me rekomandimin e dhënë dhe për cilën pjesë nuk është dakord. Sa i përket përcaktimit në leje ambalazhim në shishe ose enë, AMBU e njehson botin me një enë për ambalazhim. Pra pavarësisht faktit që flitet për ujë të ambalazhuar, autoboti/boti prej saj trajtohet si enë. Ndërkohë, nga ana tjetër “Rregullorja për ujin” e paraqet qartë përdorimin e autobotit në raste jo të zakonshme si dhe përcakton kushtet e nevojshme në këto raste. Situata paraqet nevojën për marrjen e masave të menjëhershme nga ana e AMBU-së për këtij lloj aktiviteti, për të garantuar sigurinë e konsumatorit. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

MSHMS trajton gjithashtu angazhimin për një sërë hapash të cilat pritet të merren për përmirësimin e situatës si në aspektin ligjor e rregullator por edhe në aspektin e përmirësimit të laboratorëve dhe certifikimin e tyre.

*- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 6068/2 prot, datë 21.08.2025 regjistruar në KLSH me nr. 123/9 prot, datë 19.08.2025 ka dërguar disa komente dhe shpjegime lidhur me Projektraportin e auditimit për MBZHR dhe të AKU së bashku.*

Për rekomandimin nr. 8.2 faqja 41 të Projekt raportit nga ana e MBZHR-AKU, sqarohet se në bashkëpunim më UNIDO dhe Bankën Botërore, ka ndërmarrë hapa konkrete për përgatitjen e laboratorëve drejt akreditimit sipas standardit ISO 17025:2017. Janë dorëzuar dokumentet e menaxhimit të cilësisë dhe janë planifikuar trajnime për validimin e metodave analitike. Investimet në pajisje dhe infrastrukturë laboratorike po mbështeten nga projekte ndërkombëtare. MBZHR gjithashtu ka sqaruar se, procesi i akreditimit është një objektivi afatgjatë, i varur nga mbështetja financiare dhe teknike.

### Qëndrimi i grupit të auditimit

Për sa më sipër, hapat e marra përbejnë një progres të rëndësishëm, megjithatë procesi i akreditimit ende nuk është finalizuar dhe mbetet i kushtëzuar nga financimi dhe mbështetja teknike. Si pasojë, rreziku i mos akreditimit për një periudhë të gjatë kohe është i pranishëm. Grupi i auditimit i qëndron gjetjes dhe rekomandimit.

Lidhur me gjetjen nr. 18, fq. 48, MBZHR-AKU sqaron se, kontrollet kryhen në përputhje me nenin 40 të Ligjit nr. 9863/2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, mbi bazë risku (instensitet konsumi, burime, historik shkeljesh). Frekuenca një herë në vit është në kërkesat minimale të monitorimit sipas VKM nr. 379. Për markat e tjera, AKU ka të drejtë të kryejë kontrole të pa planifikuara bazuar në dyshime apo sinjalizime.

### Qëndrimi i grupit të auditimit

Për sa më sipër, MBZHR-AKU sqaron praktikën e ndjekur, në përputhje me minimumin ligjor dhe parimin e bazimit në risk. Megjithatë, gjetja eidenton se në praktikë nuk garanton mbulim të plotë të tregut, sidomos në periudha me konsum të lartë turistik dhe kontrollin e markave të tjera në treg të cilat nuk janë prodhuar në juridiksionin e DRAKU-ve. Grupi i auditimit i qëndron trajtimit të gjetjes në material.

Lidhur me gjetjen nr. 13 dhe rekomandimin 13.1, MBZHR-AKU nuk pranon gjetjen me argumentin se ndarja e kompetencave është e qartë në kuadrin ligjor. AKU ushtron kompetencat vetëm në produktin final si ushqim (referuar ligjit 9863/2008 “për ushqimin”). Monitorimi nga burimi deri në stabiliment është i NjVKSH-ve sipas VKM-së nr. 379/2016 dhe Ligjit nr. 7643/1992. MBZHR sqaron se, interpretimi i ndryshimeve ligjore nuk ka ndryshuar formalisht kompetencat.

### Qëndrimi i grupit të auditimit

Për sa më sipër, auditimi ka evidentuar se në praktikë monitorimi i të gjithë ciklit para produktit final nuk është i mbuluar nga institucionet përgjegjëse. VKM-ja 379 nuk është e përditësuar me ndryshimet e reja ligjore. Kontrolli i lëndës së parë nuk kryhet nga NjVKSH me interpretimin që nuk është kompetencë e saj. Në këtë situatë nevojitet ndërhyrje koordinuese dhe rishikim i kuadrit rregullator, për të garantuar mbulim të plotë të të gjithë ciklit të produktit “ujë i pijshëm i ambalazhuar”. Për pasojë, grupi i auditimit i qëndron gjetjes dhe rekomandimit dhe observacioni nuk pranohet për të kryer ndryshime në material.

Lidhur me Gjetjen nr. 16, fq. 48 dhe rekomandimit 16.1, MBZHR-AKU nuk i pranon, me argumentin se janë miratuar një sërë aktesh nënligjore (udhëzime, urdhra, VKM) që përmbajnë udhëzime teknike të plota dhe të harmonizuara me legjislacionin e BE-së. Dokumentet e paraqitura (Udhëzimi nr. 20/2010, Udhëzimi nr. 22/2010, Urdhri nr. 314/2010, Urdhri nr. 266/2011, Urdhri nr. 13/2012, VKM nr. 434/2018, VKM nr. 760/2015) mbulojnë aspektet e higjienës, sigurisë, gjurmueshmërisë, etiketimit dhe trajtimeve të lejuara për ujërat minerale natyrale dhe ujin e ambalazhuar. MBZHR sqaron se këto akte përmbushin detyrimin e VKM nr. 379/2016 për udhëzime teknike.

### Qëndrimi i grupit të auditimit

MBZHAR-AKU kanë paraqitur një listë aktesh nënligjore, të cilat mbulojnë kërkesat e përgjithshme për ushqimet dhe ujin e pijshëm të ambalazhuar. Megjithatë, këto nuk përbejnë një udhëzues teknik të përshtatur, në bashkëpunim me MSHMS-në, siç kërkohet shprehimisht

nga VKM nr. 379/2016<sup>57</sup>. Për pasojë, grupi i auditimit i qëndron gjetjes dhe observacioni nuk pranohet për të kryer ndryshime në material.

Si praktikë e mirë, ekziston udhëzuesi për referencë “*Guide to Good Hygienic Practices for Packaged Water in Europe*”<sup>58</sup>.

Lidhur me Konkluzionin nr. 3, MBZHR-AKU nuk pranon konkluzionin me argumentin se, kontrolli zyrtar mbi ujin e pijshëm të ambalazhuar është i strukturuar, funksional dhe i mbështetur në kuadër të plotë ligjor dhe teknik.

#### Qëndrimi i grupit të auditimit

Për sa më sipër, problemi kryesor i evidentuar nga auditimi lidhet me fragmentimin ndërinstytucional dhe zbatimin jo të plotë të kontrollit në praktikë:

Evidentohet mungesë koordinimi mes AKU dhe NjVKSH. Segmenti nga burimi ujor deri në stabiliment mbetet pa monitorim aktiv, si dhe nuk ka pranim të mostrave nga NjVKSH për analizim të tyre, kryesisht për ato mikrobiologjike. Monitorimi/analizimi dhe analizimi është i përqendruar vetëm në produktin final dhe jo gjatë fazave të mëparshme. Nuk ka mekanizëm funksional raportimi dhe ndjekjeje për rastet jo-konform mes institucioneve. Për pasojë, grupi i auditimit i qëndron konkluzionit dhe observacioni nuk pranohet për të kryer ndryshime në material.

Lidhur me gjetjen nr. 8, MBZHR sqaron se, në vijim të projektit UNIDO – GQSP Albania, është dorëzuar paketa dokumentare për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas ISO 17025:2017 (manual, procedura operative standarde, formularë). Laboratorët janë në proces njohjeje dhe zbatimi praktik të dokumentacionit, duke përmirësuar cilësinë dhe besueshmërinë e analizave si dhe, është planifikuar trajnim për validimin e metodave dhe pasigurinë në matje. Me mbështetje nga Banka Botërore (projekti CRAD) po investohet në pajisje dhe infrastrukturë laboratorike, me objektiv final akreditimin. Qeveria shqiptare ka financuar pajisje specifike për analizimin e ujit të pijshëm të ambalazhuar dhe po kërkohet trajnimi i metodikës nga laboratorit i referencës ISUV.

#### Qëndrimi i grupit të auditimit

Masa të rëndësishme përgatitore janë marrë, megjithatë laboratorit nuk është ende i akredituar, çka do të thotë se gjetja e auditimit mbetet aktuale.

Lidhur me gjetjen nr. 9 dhe rekomandimin nr. 9.1, MBZHR sqaron se do të jetë menjëherë në zbatim planifikimi në planin vjetor me bazë rrisht për vitin 2026.

Lidhur me gjetjen nr. 10 dhe 11 MBZHR sqaron se do të jetë menjëherë në zbatim planifikimi në planin vjetor me bazë rrisht për vitin 2026.

Lidhur me gjetjen nr. 19 dhe rekomandimin nr. 19.1 do të fillojë procedurat për plotësimet e nevojshme në Udhëzimin Nr.19, datë 22.11.2022 "Për tarifatat e të ardhurave detyësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBZHR", në lidhje me analizatat e ujit.

Për rekomandimin nr. 21.1, mbi ndryshimet në rregulloren e brendshme të AKU me një seksion të posaçëm për vlerësimin e rasteve dhe informimin e publikut, nuk pranohet. Kjo me argumentin se, funksionet tashmë janë të parashikuara në nenet 33 dhe 34 të rregullores në fuqi. Ky funksion është i integruar dhe nuk kërkon shtesë. Në çdo rast informimi i publikuar është kryer, natyrisht sipas rëndësisë dhe rrisht që mbart çështja me qëllim eliminimin e situatave të

<sup>57</sup> Neni 14 i VKM-së nr. 379 datë 25.5.2016, i ndryshuar , shkronja “ç” dhe “dh”.

<sup>58</sup> Miratuar nga Komisioni Evropian:

[https://food.ec.europa.eu/system/files/2016-11/biosafety\\_fh\\_guidance\\_eu\\_guide\\_hygiene\\_packaged\\_water\\_en.pdf](https://food.ec.europa.eu/system/files/2016-11/biosafety_fh_guidance_eu_guide_hygiene_packaged_water_en.pdf)

panikut dhe marrjen e masave proporcionale. Gjithsesi mbetemi të hapur edhe për ndonjë specifikë që mund të rekomandohet në lidhje me këtë çështje. Nuk pranohet as konkluzioni nr. 4 me të njëjtat argumente.

#### Qëndrimi i grupit të auditimit

Sqarojmë se rekomandimi i referohet mungesë së një parashikimi të qartë në rregullore kur duhet të bëhet njoftimi publik dhe kush e vendos atë. Në tre rastet e problematikave të trajtuara në Raportin e Auditimit, pavarësisht përhapjes nuk është bërë njoftimi publik për produktin. Aktet rregullative janë të domosdoshme pasi ato përcaktojnë detyrat e nëpunësve dhe caktojnë rregulla të qarta mbi veprimtarinë shtetërore, që vendimmarrja të mos mbetet në gjykimet subjektive. Kjo për të pasur parashikim të qartë mbi shtrirjen e problematikës, numrin e të prekurve, urgjencës për të vepruar, strukturat që duhen të marrin një vendim mbi publikimin e rasteve dhe mënyrën e komunikimit me publikun. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në paragrafin faqe 27 të Projektraportit trajtohet se, nuk evidentohen kërkesa për t'u përmbushur lidhur me kriteret tekniko-teknologjike si përcaktohet të ligjit për ushqimin nuk qëndron. Kjo me argumentin se, ka "Listë verifikimit për inspektimin e përgjithshëm të higjienës" e cila në një ndër pikat e saj ka dhe planin HACPP. Kjo pikë përmbush kërkesën e nenit 26 të ligjit për ushqimin duke garantuar që stabilimenti ka zbatuar një sistem vetëkontrolli.

#### Qëndrimi i grupit të auditimit

Sqarojmë se, trajtimi ynë i referohet përcaktimit në ligj nenit 19, pika 12 dhe 13 mbi procedurat e dhënies së lejes për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit të ujit. Pra kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare, për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Lista e verifikimit që citohet ka të bëjë vetëm me një nga kërkesat, verifikimet e higjienës, si vetë emërtimi i saj dhe jo me procesin teknologjik. Në trajtim MBZHR-AKU i referohet gjithashtu sistemit të vetëkontrollit sipas nenit 26 që lidhet po me kushtet higjienike të prodhimit nëpërmjet zbatimit të procedurave parandaluese të sistemit të vetëkontrollit. Lidhja indirekte që bëhet me planin HACCP nuk përmbush kërkesën sipas parashikimit në ligj, për një vlerësim të drejtpërdrejtë të kërkesave teknike dhe teknologjike të stabilimentit. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

-Lidhur me gjetjen nr. 5 mbi mungesën e përfshirjes së kriterit të lejes së përdorimit të burimit si kusht për licencimin e stabilimentit institucionet MBZHR-AKU trajtojnë se, nuk qëndron pasi, AKU nuk është organ licencues për burimin ujor, por për licencimin e stabilimentit si OBU. Procesi i licencimit është i strukturuar dhe përfshin të gjitha kriteret tekniko-teknologjike dhe higjienike.

Nuk pranohet as Konkluzionin nr.1 lidhur me disponimin e lejes së burimit si kusht për licencimin. Këtu trajtohet se, nëse uji nuk përmbush kriteret e sigurisë ai nuk lejohet të dalë në treg pavarësisht lejes së burimit. Në rast revokimi apo skadimi AMBU ka detyrimin të njoftojë AKU e cila merr menjëherë masat për pezullimin e aktivitetit.

Në trajtimin e rekomandimit nr. 5.1; 5.2 dhe 5.3 rekomandimet janë pranuar.

#### Qëndrimi i grupit të auditimit

Për aq kohë sa një subjekt nuk mund të prodhojë ujë të pijshëm të ambalazhuar pa një leje të miratuar për përdorimin e burimit ujor, detyrimisht dhe AKU nuk mund ta licencojë atë. Kjo pasi, leja e burimit ujor është një kusht i domosdoshëm për prodhimin. Gjatë auditimit por dhe

nëpërmjet observimeve nuk është paraqitur asnjë kriter tekniko-teknologjik që duhet të përmbushin stabilimentet e prodhimit të ujit të pijshëm të ambalazhuar.

Në argumentet e paraqitura mbi konkluzionin, institucionet pranojnë që, mungesa e lejes sjell menjëherë pezullimin e veprimtarisë. Nëse uji nuk përmbush kriteret për tregtim pa diskutim që ai nuk duhet të dalë në treg. Ndërkohë në rastin konkret po diskutohet e kundërta, nëse duhet të salë në treg pa leje burimi ujqor.

Në pjesën vijuese të observacionit trajtohen rekomandimet nr. 5.1; 5.2 dhe 5.3 rekomandimet të cilat pasqyrohen të pranuar si dhe trajtohet angazhimi për të filluar masat për zbatimin e tyre. Pra brenda vetë observacionit ka disa trajtime kontradikore mes tyre. Në kuadër edhe të trajtimit më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

-Lidhur me gjetjen nr. 22 në Projektraportit mbi standardizimin e etiketave nuk pranohet. MBZHR-AKU trajton se, AKU nuk miraton etiketa. Ky proces ka në themel vetëdeklarimin. AKU nëse vëren se etiketa ka të meta që vinë në kundërshtim me aktet rregullatorë i kthen ato për nëse vëren të meta ja paraqet subjektit për rregullim. Nëse subjekti nuk reflekton të metat që janë vënë në dukje, përsëri subjekti mund të dal në treg me ato etiketa. Në vijim ai konsiderohet me risk dhe mbi të kryhet inspektim. Për etiketimin është VKM nr.434 viti 2018 si dhe Urdhri nr. 266 viti 2011 “Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave mineralë”. Nuk ka dalë qartë se ku konkretisht duhet të ndërhyhet pasi nuk mendojmë se ka boshllëqe nga pikëpamja e informimit të konsumatorit.

#### Qëndrimi i grupit të auditimit

Sqarojmë se, procesi i etiketimit nuk bazohet vetëm në vetëdeklarim e operatorëve ekonomikë, por gjithashtu edhe në kontrollin e organeve shtetërore. Dispozitat e VKM nr. 434 e përcaktojnë qartë detyrimin e AKU për trajtimin e etiketave të sjella për notifikim dhe mospranimin e tyre. Në rastet kur ato kanë të meta kthehen dhe në raste të tjera kur nuk kanë, bëhet një formë “aprovimi në heshtje”. Neni 29 i VKM lidh detyrimet specifike të etiketimit të këtij produkti me Urdhrin nr. 266 i cili është mjaft specifik dhe trajton detyrimet për ujërat mineralë të ambalazhuar, përmbajtjen e tyre, kur ata duhen quajtur minerale dhe kur natyrale, por edhe për të dhënat në etiketën e tyre me qëllim informimin e drejtë të konsumatorit. Pikërisht dispozitat e këtij urdhri mbi standardizimin e përmbajtjes nuk rezultojnë të jenë përmbushur si duhet nga ana e strukturave të kontrollit ushqimor. Në përfundim, në kuadër të ushtrimit të funksioneve publike është detyrë e hallkave menaxheriale të bëjnë standardizimin e veprimeve administrative, për zbatim të njëjtë dhe efektiv të legjisllacionit në fuqi. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**